

Ngaha “të kthyerit” e V. Meksit tek “epistasía” e G. Gjirokastritit: drejt një botimi krahasues të teksteve shqip të “Dhjatës së Re”*

Dhori Q. Qirjazi
Universiteti Aristoteli i Selanikut

“Studiuesit tani kanë mundësinë të përcaktojnë me saktësi punën që ka bërë Gjirokastriti, duke e krahasuar botimin me dorëshkrimin e Meksit [...] Një studim i imtë do të ishte me interes për të parë punën e një redaktori shqiptar, ndoshta të parit të dokumentuar, në fillim të shekullit XIX. Nga karakteri sistematik i ndreqjeve do të nxirreshin edhe kriteret gjuhësore të redaktimit.” (Lloshi 2012, 89-90).

1. Domosdoshmëria dhe rëndësia e një botimi integral të teksteve të “Dhjatës së Re”¹

Pak lexues dhe studiues e dinë se mes Korfuzit dhe brigjeve përballë kanë ekzistuar lidhje të hershme dhe se ishulli i feakëve ka pas qenë në krye të herës i ngjitur gjeologjikisht me Epirin. Pak njerëz e dinë, gjithashtu, se, në punë të lëvrimit të shqipes, Korfuzi ka pasur një rol të rëndësishëm. Rastësia të befason edhe këtu me “lojnat” e saj. Themeluesi i degës së British and Foreign Bible Society (BFBS) për Heptanezin ka qenë Baroni Emanuil Theotoqis², pinjoll i familjes së njohur nën kujdesin e së cilës u organizua dhe u realizua përkthimi, redaktimi dhe botimi provë i Ungjillit pas Mateut më 1824 dhe i krejt “Dhjatës së Re” më 1827³.

Më 1827 vinte në jetë K. Kristoforidhi, i cili do ta thellonte më tej punën e përkthimeve fetare, por edhe do të shkruante gramatikën e toskërishtes e do të përgatiste fjalorin e gjuhës shqipe, që nuk arriti ta shihte të shtypur në gjallje të tij. Vepra, në saje të disa rrethanave fatlume dhe të interesimit të njerëzve që besonin në mundësinë e lidhjeve e të bashkëpunimit të grekëve me shqiptarët, -e njëri nga këta pati qenë kryeministri grek i asaj kohe Jeorjios Theotoqis, një pinjoll tjetër i familjes

*Ky punim është botuar shqip në revistën Studime Filologjike (1-2/2019, e cila qarkulloi më pas) dhe ruan përgjithësisht strukturën dhe përmbajtjen e motërzimit anglisht të tij, të vitit 2020, në përmbledhjen me aktet e Konferencës së Buçimasit (shtator 2019), botuar me përkujdesjen dhe shpejtësinë e Prof. Bardhyl Demirajt. Ndërkaq, koha që ndërmjetësoi deri në botimin e tekstit shqip i dha mundësinë autorit ta përditësojë me të dhëna të reja.

**Falënderoj Prof. Xhevat Lloshin dhe kolegët e miqtë Spiro Gjoni, Thoma Qendro, Gëzim Gurga, Eljana Mosko-Kokalari, Kostas Giakoumis, Sokol Çunga dhe Spiros Gaoutsis (Korfuz) për ndihmën e çmuar të tyre.

¹ Për historinë e përkthimeve të “Dhjatës së Re” në shqip, shih Lloshi 2012 dhe 2018.

² U themelua në korrik 1819. Për hollësi shih letrën e R. Pinkertonit të 24 korrikut 1819 (Lloshi et al. 2017, 7-8), si edhe Raportin I për veprimtarinë e asaj dege (shtator 1820), ku thuhet ndër të tjera se “As ideja për të përkthyer në gjuhën shqipe Ungjillin e Shenjtë nuk iu shqit kurrë nga mendja Komitetit [të Degës Joniane]. –Madje duke përfituar nga një Gramatikë e asaj gjuhe, dhuratë që i ofroi i mirënjohuri z. Pinkerton, i cili meriton lëvdata të shumta, Shoqata Joniane filloi të marrë masa për zbatimin e idesë së mësipërme” [«Ούτε ο στοχασμός του να μεταφρασθή εις την Αλβανικήν Γλώσσαν το Ιερόν Ευαγγέλιον ευγήκε ποτέ από τον νουν του Εφορείου. –Ωφελούμενον μάλιστα από το δώρον μιας Γραμματικής της αυτής γλώσσης, όπου επρόσφερεν εις την Ιωνικήν Εταιρείαν ο πολλοτάτων επαίνων άξιος και έγκριτος Δρ Πίνκερτον, άρχισεν να λαμβάνη μέτρα διά την εκτέλεσιν του άνωθεν στοχασμού του.»] (Αναφορά 1820: 4-5). Shih poashtu Shtojcën me përmbajtjen e Raportit III të Komitetit për vitet 1823-24.

³ “Une version en dialecte Albanais du Nouveau Testament (dialecte qui n’avait jamais été écrit) vient d’être imprimée, pour mettre à portée de ce peuple le Divins enseignements de l’Evangile.” (Theotoky 1826, 85).

së shquar korfiote-, u botua në Athinë më 1904, me titullin Λεξικόν της Αλβανικής Γλώσσας, me alfabetin grek të përshtatur për nevojat e shqipes, dhe me pjesën shpjeguese (metagjuhën) në greqisht.

Pak vite më pas stafeta e përkthimeve fetare do t'i kalonte Fan Nolit, që shqipëroi e u përçoi shpirtin e shqipes aq e aq veprave, e që i fali asaj një nur të paparë.

Por edhe para shek. XIX e XX qarku kulturor ortodoks i ka dhënë shqipes impulse që e mbajtën të gjallë e të paepur. Kontributi i qyteteve si Berati, Voskopoja, Elbasani, Durrësi, Korça, Gjirokastra dhe tradita e krijuar në to nuk janë studiuar aq sa duhet deri më sot, sepse kanë bërë “mëkatin” të jenë shkruar në greqisht e të përcjellin jehonën e një areali kulturor, i cili, objektivisht, edhe e ka penguar shqipen në momente të caktuara, dhe i cili, po objektivisht, në një kuadër më të gjerë, ndihmoi në krijimin e kushteve për studimin dhe lëvrimin e saj⁴. Gjithashtu, ato janë parë shpesh me “syrin e njerks” edhe ngaqë, jo rrallë, vënia e shenjës së barazimit mes ortodoksisë dhe helenizmit ka shkaktuar ndër shqiptarë njëfarë stepjeje për studimin e traditës ortodokse dhe të prodhimit intelektual të saj.

Studimi i trashëgimisë kulturore të komunitetit ortodoks të Shqipërisë së Jugut do të shërbente edhe si një urë lidhëse me trashëgiminë bizantine të shqiptarëve, ku vërehen po ashtu mangësi të njohjes së saj. Disa botime të kohëve të fundit (Demiraj 2019, Γιακουμής 2020) etj.) ngjallin shpresën se po bëhen hapa për ta ngushtuar hendekun e krijuar dhe se kolegët më të rinj, të çliruar prej paragjykimesh⁵ dhe të pajisur me njohuri solide të gjuhës dhe të historisë bizantine e pasbizantine⁶, do të kontribuojnë cilësisht në këtë lëmë.

Nga ana tjetër, bota shkencore europiane e njohu shqipen kryesisht nëpërmjet “Dhjatës së Re” të Korfuzit, botimi dykolonësh i së cilës⁷ ua lehtësoi punën studiuesve që njihnin greqishten e që përpiqeshin të hynin në të fshehtat e shqipes.

⁴ “Gjatë fazës kombëtare të Ballkanit, sikurse duket në rastin e shqipes apo të bullgarishtes, vërejmë që, sa më shumë fitojnë terren -funksionalisht dhe simbolikisht- gjuhët e kombeve të tjerë ballkanikë, aq më shumë tërhiqet nga fronti edhe greqishtja, “mbretëresha e gjuhëve”, siç e pati quajtur më 1866 J. Vretoja. Ky është një realitet historik, që i përgjigjet edhe logjikës më të thellë të gjërave. Greqishtja, kjo gjuhë që rrethana fatlume historike i dhanë një rol të veçantë, e qetë dhe hijerëndë kundron rrugën e gjatë të përshkuar, gjatë së cilës herë e *instrumentalizuan* e herë e *demonizuan*, njëra palë për marrje trojesh, tjetra palë për mbrojtje trojesh. Sot, me mendje të kthjellët, mund të themi se është gabim metodologjik dhe historik të vendosësh shenjën e barazimit mes hapësirës kulturore të greqishtes dhe hapësirës etnologjike të grekëve. Greqishtja, le ta themi edhe një herë, ka qenë gjuhë kulture, një *lingua sacra et franca* e Ballkanit të shek. XIX e më herët, dhe nuk është e thënë se kudo ku flitej greqisht kishte medoemos edhe grekë. Por edhe të thuash që greqishtja është ndodhur vazhdimisht përballë gjuhëve të tjera të Ballkanit, do të thotë të mos mbash parasysh specifikat e asaj periudhe dhe të mos marrësh në konsideratë atë që vetë faktet historike e dëshmojnë më së miri: pati përplasje, por pati edhe sinergji.” (Qirjazi 2018, 251-252).

⁵ Për shembull, fakti që D. Voskopojari, në librin «Εισαγωγική Διδασκαλία» (Venecie 1802), i nxiste ballkanasit të braktisnin gjuhët e veta dhe t'i ktheheshin greqishtes, duhet vendosur në kuadër të kohës dhe nuk mund të jetë arsye për të mos e njohur atë dhe veprën e tij (në greqisht, shqip, arumanisht dhe bullgarisht), radhët e mëposhtme të së cilës na japin një tjetër imazh të asaj figure, duke e kthyer nga murg në një “rebel social”: “*Haramitë[hajdutët] vjedhinë natënë edhe kursarëtë dalinë ditënë edhe shkelinë karvanat. Po kadillarët edhe pashallarët zveshinë jetënë [botënë] edhe koxabashitë me të mir zant pinnë gjaknë e varfëret. Pandae zëmëroetë perëndia edhe ne mundon me sëmundëra me murtajt me lëngim me prënjerë mort.*” (Shih për më tepër hollësi, Qirjazi 2018, 251-252)

⁶ Në Shqipëri, studiuesit që njohin mirë greqishten dhe botën greke janë të rrallë dhe kjo ka çuar në mekje të dialogut shkencor dhe në zbehje të interesimit për të rejat e fushës.

⁷ Për botime të këtij lloji, shih, përgjithësisht, Lindstedt 2016, ku “...the use of parallel columns in printed books, manuscripts, and private notebooks” konsiderohet “as an iconic expression of the sociolinguistic situation of the time.” (ibidem 51).

Në këtë pikë ia vlen të përmendim sa lart e vlerësonte Dh. Kamarda atë libër:

“Libretë e kartatë që unë kamë përdorunë, e këshillëtuarë, e spudhasurë për të shkruomit arbërishtë, janë afërose gjithë sâ mun të gjëndenë, e që u kanë shpallurë njerri sotë: më tepër dha: Hahn, *Albanesische Studien*; edhe prân: Reinhold; Xylander; Stier; Crispi; Dorsa, *Studii etimol.*, e *Ricerche e Pensieri*, etc.; De-Rada, *Poesie Albanesi*; Chetta, *Dizion. Alb.*; Rossi, *Vocabol. Epirot.*; Da Lecce; Bogdani; P. Basile; Guagliata; e tjeratë libre typosurë ndë Romë, pa ëmbi gjithë P. Budi, që ishtë më i vjetëri, e më i miri: **pôr si krie e parë Dhjata e reë, të Korfoitë**; e gjithë prâ atô vivlia, karta, e të shkruome namatisurë përei meje 'nde libri emi, *Grammat. Comparata sulla lingua Alb.*, Livorno 1864, ed *Appendice alla Gram.* etc. *Qualche prosa e Versi Alb. tradotti e annotate*, Prato 1866.”⁸ (Nënvizimi yni, Dh.Q.Q.)

Përveçse kulturore dhe historike, rëndësia e botimit është edhe mirëfilli gjuhësorë⁹, ngaqë “Dhjata” s’pushon së qeni një burim i çmuar të dhënash për pjesën jugore të arealit të shqipes në kapërcyell të shek. XVIII e XIX. Për ilustrim, le të marrim disa shembuj prej përkthimit të Ungjillit pas Joanit dhe të përqendrohemi në nivel leksikor.

Nukë munt jeta t’u **urrejë** juuve, ma mua më **urren**, sepse u bëj të dukenë punëtë e saaj që janë të këqia. / *Nukë mund bota t’u mçojë juvet, ma mua më mçon, sepse unë bëj të dukenë punët’ e saaj që janë të këqia.* (Joani 7/7)

Do të mos u lëë juuve **të varfërë** [ορφανούς]; do të kthenem mbë juu. / *Do të mos u lë juvet të varfërë; kthenem mbë ju.* (Joani 14/18)

Nuk’ e dii që kam **urdhër** [εξουσία] të të kryqas edhe **urdhër** të [të] shpëtoj? / *Nuk’ e di që kam urdhër të të mbërthej ti mbë kruq, edhe urdhër kam të të lëshoj ti?* (Joani 19/10)

E pastajë thotë Thomait, vurë gishtinë tënd këtu, e shih duartë e mia; e bjerë dorënë tënde e vure ndë brinjë time, e mos u bën **i paabesë**, po beso. / *E pashtaj i thotë Thomait, bjerë gishtinë tënd këtu, e shih duart’ emi; e bjerë dorënë tënde, e vure ndë brinjë time, e mos u bën i pabesë, po beso.* (Joani 20/27)

Në shembujt e dhënë më sipër, te G. Gjirokastriti shfaqet folja *mçoj* si barazvlerëse e *urrej*. Një folje e tillë nuk dimë të përdoret më në të folmet e toskërishtes dhe duket se lidhet me foljen *çmoj* dhe kuptimin më të hershëm të saj, që del te *përçmoj* (Topalli 2018, 345).

Po kështu, mbiemri *i varfër* (< lat. orphanus) ruan kuptimin e kryehershëm të tij, ndërsa fjalët *urdhër* e *i pabesë* kanë përkatësisht kuptimet ‘pushtet’ dhe ‘(njeri) që s’beson’, e kështu me radhë.

⁸ Camarda 1867, X, shënim. Shih edhe vlerësimin e Kamardës, i cili besonte që përkthimi i “Dhjatës së Re” i Korfuzit që “il più ragguardevole monumento che esista finora de quell’idioma epirotico.” (Camarda 1866, XII). Më shumë hollësi te Gurga 2002-2005, 6-7.

⁹ Për kuadrin ballkanik të kësaj vepre shih Lloshi 2018.

Studimi i gjuhës së “Dhjatës së Re” paraqet interes edhe për teorinë e gjuhëve në kontakt jo thjesht për marrje-dhëniet leksikore, por edhe për nivelin morfosintaksor. Fjala vjen, te përkthimi i Ungjillit pas Joanit kemi gjetur

a) Një trajtë të pazakontë të së ardhmes kushtore, ndërtuar, besojmë, sipas modelit të greqishtes:

Ju përgjegj Iisui, e i thotë asaj, të njohe ti dhurëtiinë e Përndiisë, e çiri është ai që thotë ëmë të pii, ti deshe t’i kërkoje atij. E ai desh të t’ ip tyj ujë të gjaallë. /E ju përgjegj Iisui, e i thot’ asaj: të njohe ti dhurëtin’ e Perndisë, edhe cili është ai që thotë ti, nëmë të pi; ti deshe ti kërkoje atij, e ai desh të t’ ip ti ujë të gjallë. (Joani 4/10)

Shih më poshtë tekstin e greqishtes: αν ήξερες ... εσύ ήθελες του ζητήση, και ήθελε σου δώση:

<p>10. Απεκρίθη ὁ Ἰησοῦς καὶ εἶπέν της· ἂν εἴξευρες τὴν δωρεάν τοῦ Θεοῦ, καὶ ποῦς εἶναι ἐκεῖνος ὅπου σοῦ λέγει· δός μου νᾶ πῖω· ἐσύ ήθελες τοῦ ζητήση, καὶ ήθελε σοῦ δώση νερὸ ζωντανόν.</p>	<p>10. E γιου περφέιτκ Ἰησοῦι, εἰ ἰ θότ’ ἀσαίγ’ τὲ νιόχε τὶ δουρετίν’ εἰ Περντί-σε, εἰ δε τζιλ: ἔστ’ αἰ νᾶ τὲ θότε τὶ, νέμε τὲ πῖ· τὶ δέθε τὶ κερκόγε ἀτίγ, εἰ αἰ δέθ τὲ τὲ ἰπ τὶ οὔγε τὲ φιάλε.</p>
--	--

dhe tekstin e greqishtes së vjetër: **Ιω Δ-10** ἀπεκρίθη Ἰησοῦς καὶ εἶπεν αὐτῇ· εἰ ἤδεις τὴν δωρεάν τοῦ Θεοῦ, καὶ τίς ἐστὶν ὁ λέγων σοι, δός μοι πιεῖν, σὺ ἂν ἤτησας αὐτόν, καὶ ἔδωκεν ἂν σοι ὕδωρ ζῶν.

b) Një sintaksë të pazakontë të foljes dëgjoj, ndikuar edhe kjo prej greqishtes:

Ndajë shumë ngaha mathitiitë e tiij, si digjuanë, thanë këtë fjalë: e ashprë është këjo fjalë, kush mund ta digjojë? / *Andaj shumë nga mathitit’ etij, si digjuanë, thanë: e ashprë është këjo fjalë; kush mund ti digjojë atij?* [τις ημπορεῖ να του ακούη;] (Joani 6/60)

Ma e diimë që Perndiia nukë digjon fajtorëtë, po kush ndeeron Perndiinë, e bën atë që do Perndiia, këtij i digjon Perndiia./ *Ma e dimë që Perndia nukë digjon fajëtorëtë, po kush nderon Perndinë, e bën ato që do Perndia, këtij i digjon.* (Joani 9/31)

Sepse shumë ngaha ata thoshnë, ai është i xhindosurë, e ka humburë mentë; ç’ rriji e e digjoni?/ *Se pse thoshnë shumë nga ata, ai është i xhindosurë; e ka humburë mënd’ etij; çriji e i digjoni atij?* (Joani 10/20)

<p>20. Καὶ πολλοὶ ἀπ’ αὐτοῦς ἔλεγον· φαιμόνιον ἔχει, καὶ λωλαίνεται· τί τοῦτο;</p>	<p>20. Σὲ ψὲ θόσνε σοῦμε γκα ἀτά, αἰ ἔστ’ ἰ τζιντόσουρε· ἔκκ χούμπουρε</p>
--	--

Κεφ. 10.
ἀκούετε;

ΚΑΤΑ ΙΩΑΝΝΗΝ.

333

Ἰ μὲντ’ ἐτίγ’ τζήγι εἰ ἰ δῖφόνι ἀτίγ;

Ἰω I-20 ἔλεγον δὲ πολλοὶ ἐξ αὐτῶν· δαιμόνιον ἔχει καὶ μαίνεται· τί αὐτοῦ ἀκούετε;

Krahas studimit të teksteve të përkthimit e të redaktimit, mbetet ende shumë për t'u bërë sa i përket njohjes së jetës dhe të aktivitetit të V. Meksit dhe të G. Gjirokastritit. Sa i takon pyetjes kush ua propozoi Meksin si përkthyes misionarëve të BFBS, mund të supozojmë se ka qenë Aleksandros Vasiliou, degë e një familjeje të njohur tregtare të Gjirokastrës, mik i B. Kopitarit dhe moshatar, duket, i Meksit. Vasiliou banonte në Vjenë dhe qe njëri prej mbështetësve kryesorë të revistës së iluministëve grekë “Logios Ermis/Hermesi i letrave”, e cila qarkulloi gjatë dhjetëvjeçarit të dytë të shek. XIX. Ai, si njohës i shqipes, ka gjasa të jetë autori i disa recensioneve anonime të revistës në fjalë, ku flitej për Shqipërinë dhe shqiptarët (Qirjazi 2014, Kyriazis 2015).

Nga ana tjetër, përveç një dokumenti të Kodikut të Mitropolisë së Gjirokastrës, prej nga mësojmë se G. Gjirokastriti mbante mbiemrin Stefou (Γιακουμής 2020, Dok. 107, 4 mars 1831), në Arkivin Qendror të Shtetit Grek janë gjetur disa letra që vëllai i Aleksandros Vasiliou-t, Mihali, i pat dërguar Gjirokastritit në vitet 1822-1826 (Pέππας 1989, 356, shën. 124).

Po ashtu, të dhëna me interes për arsimin në Gjirokastër gjenden në dy dorëshkrime të gjetura në Korfuz, që lidhen me shkollën greqisht të qytetit gjatë shek. XVIII (Τζιβάρα 2003). Aty gjejmë edhe një numër tekstesh greqisht shkruar nga Efstrat Vithkuqari, mësues i asaj shkolle.

2. Rrethanat

Për mënyrën si përkthente Meksi nuk kemi asnjë të dhënë direkte apo referencë të atij vetë. I ngarkuar fillimisht me redaktimin e përkthimit të “Ungjillit pas Mateut”, Grigori nuk ka pasur vërejtje thelbësore për punën e Meksit dhe ndoqi sistemin e këtij, por në vazhdim e shkroi përsëri të gjithë Mateun, duke synuar një përkthim fjalë për fjalë¹⁰. Nga ana tjetër, kemi dëshminë se Grigori

“e pranoi me gatishmëri [të rishikonte përkthimin e Meksit] dhe thotë se kuptimi është dhënë mirë, por *shprehjet nga disa pikëpamje kanë nevojë të ndryshohen*”¹¹.

Tani mësojmë gjithashtu se

“Kur të mbërrijë [pjesa tjetër e dorëshkrimit], kryepeshkopi Grigori do t’i kushtojë menjëherë vëmendjen. Në të vërtetë ai është përgatitur për të, sepse *ka përkthyer Markun* dhe kur të mbërrijë vepra, ai do të nxjerrë një kopje të pastër për Komitetin tonë nëpërmjet një krahasimi të dr. Meksit me punën e vet. Atij i është kërkuar korrektësi dhe vëmendje e rreptë ndaj greqishtes dhe ai i përmbahet me zell kësaj.”¹²

Nga letërkëmbimi i misionarëve të BFBS shohim se edhe Meksi edhe Grigori u është dashur të punojnë mbi të njëjtën platformë, të përcaktuar qysh me marrëveshjen Pinkerton-Meksi të 19 tetorit 1819:

“Dr. Vangjel Meksi jo vetëm zotohet të ushtrojë gjithë aftësitë e tij *për ta bërë përkthimin besnik dhe në përputhje me tekstin*, por njëkohësisht edhe *t’ia nënshtrojë*

¹⁰ “Pjesën që mungonte te dr. Meksi ai [Grigori] e ka plotësuar nga kreu 21 deri te 27. Të gjithën e ka parë dy herë. Herën e parë ndoqi tepër sistemin që kishte ndjekur Meksi, [...] dhe me kërkesën time të veçantë ai e shkroi përsëri të gjithë dhe iu përmbajt fjalë për fjalë origjinalit. ... Gjatë rishikimit ka qenë shumë i kujdesshëm.” I. Lowndes për R. Pinkertonin, Korfuz, 25 shkurt 1824 (Lloshi 2017, 25-26).

¹¹I. Lowndes për R. Pinkertonin, Korfuz, 15 janar 1824 (Lloshi 2017, 21-22).

¹² I. Lowndes për Komitetin e BFBS Londër, Korfuz, 7 korrik 1824 (Lloshi 2017, 37).

rishikimit nga dy klerikë shqiptarë të arsimuar, me qëllim që të ushtrohet çdo kujdes i mundshëm për ta bërë gjuhën të saktë dhe në përputhje me idiomën e shqiptarëve ashtu siç flitet në Janinë, dhe të lehtë për t'u kuptuar nga kombet për të cilat është përcaktuar, përpara se të jepet në shtyp.” (nënvizimet tonat, Dh.Q.Q.)¹³.

Ashtu sikurse ndodh më së shumti me gjuhët letrare, qofshin edhe në hapat e hershëm të tyre, faktorë jashtëgjuhësorë, në rastin tonë nevoja e përhapjes së fjalës së Zotit, krijuan premisat për lentimin e një shqipeje të shkruar, të saktë e të kuptueshme nga njerëzit për të cilët destinohet. Misionarët e BFBS po bëheshin kështu hartuesit dhe promovuesit e parë të një politike gjuhësore¹⁴ për shqipen në fazën para-kombëtare¹⁵ të saj.

3. Çështje të transkriptimit dhe të leximit të dorëshkrimit

Prof. Xh. Lloshi shkruan se

“Ne kemi tashti një dorëshkrim të kopjuar nga dorëshkrimi i Meksit. Që kjo është një kopje duket qartë nga gabimet, sepse janë të tilla, që vështirë të bëheshin nga Mexi, ndërsa më e drejtë është t'i vishen një njeriu, që nuk e njihnte shqipen.” (Lloshi 2012, 130)

Dhe vërtet, vihen re luhatje përndryshe të pashpjegueshme në mënyrën e të shkruarit të së njëjtës fjalë apo të së njëjtës fonemë. Fragmenti i mëposhtëm i kopjes së dorëshkrimit të Meksit nuk lë fije dyshimi për këtë¹⁶.

¹³ Marrëveshja e R. Pinkertonit me V. Maksin, Stamboll, 19 tetor 1819 (Lloshi 2017, 10).

¹⁴ Këtu kemi një tjetër “surprizë” arkivore dhe historike: Sipas një letre të R. Pinkertonit për BFBS (Kostandinopojë, 27 tetor 1819), Patriarku Grigori V “denjoi ta lexonte me interes të dukshëm [marrëveshjen e Pinkertonit me Maksin] dhe për këtë punë, të cilën e quante një nevojë të madhe, premtoi të jepte çdo mbështetje të mundshme.” (Lloshi et al. 2017, 12).

¹⁵ Termi përdoret sipas përkufizimit të Detrez-it (2013: 13): “Në Ballkan, me fazë para-nacional(ist)e kuptojmë periudhën historike që zuri fill pas pushtimit Otoman dhe u mbyll me depërtimin e nacionalizmit si ideologji e si ndjenjë si dhe me fillimet e proceseve komb- e shtetformuese. Nga pikëpamja kohore, mbyllja e fazës para-nacional(ist)e mund të vendohet në fundet e shek. XVIII dhe në fillimet e shek. XIX, varësisht nga rajoni i Ballkanit dhe nga klasa sociale që merret në shqyrtim.” Do të ishte gabim të mendohej se në fazën para-kombëtare nuk qenë formësuar elementët që do të përbënin më pas tharmin e formimit të ndërgjegjes kombëtare e të proceseve që çuan në krijimin e shteteve nacionale në Ballkan. Po të vërehet, fjala vjen, Raporti III i veprimtarisë së Shoqërisë Biblike Joniane (Korfuz 1825), që po e sjellim në dritë për herë të parë (shih Shtojcën), aty ka referenca të qarta për shqiptarët, shqipen dhe Shqipërinë, të cilat shfaqen edhe më herët në burime të tjera. Shih edhe sa thuhet për këtë temë në përmbyllje të punimit tonë.

¹⁶ Të shihet, p.sh., si janë shkruar fjalët *pezevoletë* dhe *e tyre* sikurse edhe fakti që me shenjat *kh* jepet një herë fonema *q* dhe tjetrën herë fonema *k* e shqipes.

Transkriptimi i Lloshit (2012, 236) i dorëshkrimit të Meksit.

8. E nd' është që dora, aa këmba ote të skandalis, përei ato, e shtëri poshtë; se është më mirë mbë tyj të hyysh ndë jetë i çalë, aa dorëkuc (kucodorë) se të keesh dy duar, aa dy këmbë, e të vihesh ndë flakë të paasosurë.

9. E nd' është [që] syyri yyt i djathti të skandalis, nxerre atë, e shtëre poshtë; është më mirë për tyj monosyy të hyysh ndë jetë, se të keesh të dy syytë e të hidhesh ndë furrë të zjarrit.

Transkriptimi i propozuar prej nesh, mbi bazën e dallimit të y, u, dhe i.

Pas konstatimit se Meksi e përdor rregullisht zanoren y, ndërsa Grigori e anashkalon atë duke e sheshuar me i dhe u, dhe shpjegimit fillimisht të njëmendtë se aty kemi të bëjmë me pasqyrim të veçorive dialektore të trevave prej nga ata vijnë, lind pyetja nëse Grigori ka pasur arsye më të thella për t'i dhënë zgjidhjen që i dha ndërdyshjes objektive *me* apo *pa* y.

Mendojmë se përgjigjja lidhet me atë motërzim gjuhësor që Grigori, sipas porosive këmbëngulëse të përfaqësuesve të BFBS, e konsideronte si trajtë përfaqësuese e më të përgjithshme të shqipes së folur në vilajetin e Janinës e më tej, në Greqinë kontinentale e ishullore¹⁹. Ky parapëlqim i tij mbase shpjegon edhe numrin relativisht të madh të turqizimave e të greqizimave që ai përdor, për të cilat do të flitet hollësisht më poshtë, por këtu, përmes një shembulli, do të desha t'i mëshoj më fort idesë se Grigori, me veshin të rrahur në të folmet arvanitase²⁰, transplanton në përkthim edhe elementë të tyre.

Në redaktimin e përkthimit të Ungjillit pas Mateut (2/11) Grigori zëvendëson foljen *gjenë* të Meksit me *çuan*:

¹⁹ "...dialekti i tyre [i banorëve të ishujve Poros, Hidra, Specia] është i përzier mjaft me fjalë e shprehje turke dhe greke. Ata më treguan se dialekti i tyre ndryshon mjaft prej shqipes që flitet në Janinë. Të gjithë i përkasin kishës ortodokse dhe janë në po atë gjendje të mjerueshme të paditurisë për fenë, ashtu si edhe vëllezërit e tyre në malet e Epirit. Ndërsa po të merret parasysht, përveç kësaj, se jo thjesht banorët e Ilirisë së lashtë dhe të Epirit flasin shqip, por edhe që një e treta e banorëve të Athinës, një pjesë e madhe e popullsisë së Atikës dhe të Moresë janë gjithashtu shqiptarë dhe flasin të njëjtën gjuhë, pak a shumë të prishur, detyrimisht del në pah rëndësia e gjerë e një versioni të Shkrimeve të shenjta në dialektin që kuptohet më përgjithësisht të asaj gjuhe." R. Pinkertoni për Londrën, Stamboll, 25 shtator 1819 (Lloshi 2017, 8-9).

²⁰ Fonema y mungon sistematikisht nga të folmet arvanitase, me përjashtim të atyre të zonës së Trakës, që, siç dihet, janë ngulime më të vona popullsisht shqipfolëse (kuntim gojor i kolegut T. Jochalas). Për mungesën e fonemës y në "nordostattikoböotischen (NOAB) Mundart" të arvanitishtes shih edhe Sasse 1991, 52.

E si hyjnë ndë shtëpi e *gjenë* djalënë me Mariinë, t'ëmënë e tij bashkë, e raanë, e ju falë, e hapnë thisavrot' ee tyre, e i dhanë dhurëti aar, thimjamë edhe smirnë²¹. (Meksi, Mateu 2/11)

<p>ΙΙ. Καὶ ἔζοντας νὰ ἔλθοῦσιν εἰς τὸ σπῆτι, εὐρέθικαν τὸ παιδίον μαζὺ μὲ τὴν Μαρίαν τὴν μητέρατου· καὶ ἔπεσαν καὶ τὸ ἐπροσκύνησαν· καὶ ἀνοίξαντες τοὺς θησαυροὺς των. τοῦ ἔφεραν χαρίσματα, χρυσάφι, καὶ λίθων, καὶ σμύρναν.</p>	<p>II. E si hyjnë përëntra në shtëpi, t'ziouane d'gjalene p'aske me t'emev' etig Marivne, e rane mpe de, e giou fale atig' e gapne xazinév' etoure, e idane dourati ar, e de thimgiamë, e de smyrne</p>
--	--

Sipas Lloshit (2012, 321), “aty ku Meksi (2:11) e kishte: *e gjenë djalënë*, Grigori është larguar nga origjinali dhe e ka bërë: *çuanë djalënë bashkë me Marinë*.” Poashtu, transkriptuesi dhe komentuesi i përkthimit të Grigorit, Th. Qendro, e vëren këtë ndryshim dhe shënon se “mund të jetë gabim shtypi për: *çquanë*; në tekstin gr. është *gjetën*; [ndërsa te] Kristoforidhi (1872, 1879): *gjetmë*.” (Qendro 2016, shënimi për Matth. 2/11).

Në të vërtetë, folja *çoj* me kuptimin ‘gjej’ përdoret kryesisht nga arvanitasit: *ευρίσκω* [‘gjej’], *çonj*, *gjenj* (Γιοχάλας 2006, B’ 616), e *gjejmë* tek arbëreshët: *çonj* ‘rinvenire, rintracciare, trovare’ (Giordano 2000, 62), por gjurmë të saj dëshmojnë edhe “në të folët e Gjirokastrës [ku] përveç *çoj* ‘gjej’ edhe *çonem* ‘rriem’, u çua ‘u rrit, ka hedhur shtat’; ‘gjej’ nga ‘ngre, gjurmoj’, ‘rriem’ nga ‘ngrihem, shkoj përpjetë’.” (Çabej SE III 129). Meqenëse, sipas Johalas-it (Γιοχάλας 2002, 378) folja *çonj*, në mjaft vise të Greqisë, edhe në Negroponte (Eube), ku Grigori pat shërbyer si mitropolit, haset gjithnjë me kuptimin ‘gjej’, nuk është çudi që ai ta ketë përdorur si një urë lidhëse²² mes shqipes së Gjirokastrës²³ (Epirit) dhe arvanitishtes²⁴. Studimi sistematik i mbarë tekstit të Gjirokastritit do të sjellë ndoshta të dhëna të tjera në të mirë të hipotezës sonë²⁵.

Na duket i mbështetur mendimi i Lloshit (2012, 146, 152) se me përkthim-redaktimin e Meksi-Gjirokastritit kemi një përpjekje të hershme për krijimin e një koineje të shkruar të shqipes. Përveç argumenteve që sjell Lloshi, është për t’u

²¹ Trajtat me v të Grigorit në botimin e 1827-s për fjalët thimiamë (θυμίαμα) dhe smirnë (σμύρνα) pasqyrojnë prirjen e tij për të ruajtur ortografinë burimore të fjalëve me prejardhje nga greqishtja.

²² Një çështje më vete e mjaft komplekse, të cilën do ta trajtojmë herë tjetër (“lesh-e-li kaotik, që duket sikur mbretëron këtu”, e cilëson Çabej 1973, 119) është se në dorëshkrimin e Meksit pasqyrohet kuantiteti i zanoreve. Lloshi e ka ruajtur në transkriptim, ndërsa Gjirokastriti e ka mënjanuar për arsye, me sa duket, praktike. Ndërkaq, nga këndvështrimi i shqipes së sotme letrare Grigori kishte pasur të drejtë.

²³ Marrja selektive e karakteristikave të së folmes së Gjirokastrës duket, p.sh., në faktin se Grigori e ka lënë mënjanë alternimin *dh-ll* të kësaj të folmeje.

²⁴ Shënojmë se te Ungjilli pas Markut (1/37) Grigori mban foljen *gjenë* të Meksit: E si e *gjenë* i thanë atij që të kërkohënë gjithë. // *E si e gjenë i thanë atij; që të kërkohënë gjithë*.

²⁵ Një përjasje e tekstit të Dhjatës me tekstet e botuara nga Pedersen më 1895 (çamërisht) dhe nga Reinhold më 1855 (arvanitisht) tregon qartë afrinë e ngushtë dhe shtratin e përbashkët të të folmeve jugore të toskërishtes. Shih, p.sh., përdorimin e kohës së pakryer: *dua j ta vrit, po nukë mund* (Meksi, Marku 6/19) *nukë dua j ta njih atë njeri* (Grigori, Marku 9/30) *u kumbis të flij sa të shkon vapa* (Pedersen 1895, 51) *ajo rrij e klaj edhe s’dua j të bën punë* (Pedersen 1895, 80) *më zilepsnë e dojnë të më vrisnë* (Klosi 2005, 223) *nëkë dij çë të bën* (Klosi 2005, 212).

shënuar, p.sh., fakti që tek të dy autorët vihet re një përdorim me shtrirje të madhe i trajtës me *do të* të kohës së ardhme, e cila përbën edhe sot një karakteristikë dalluese të shqipes letrare dhe një ballkanizëm të saj. Po ashtu, përpjekja për një koine të shkruar të toskërishtes së poshtme duket edhe në shpeshtësinë e përdorimit të trajtave mohuese me *do (të) mos* të së ardhmes²⁶, të cilat hasen në të folme të toskërishtes²⁷ e në arvanitishten²⁸, por që nuk u përgjithësuan në shqipen letrare. Ka madje raste kur Grigori, në vend të trajtave me *nuk* të Meksit, të pakta në numër, përdor trajtat përkatëse me *mos*²⁹.

Duke iu përmbajtur vërejtjes së Lloshit (2012, 131) se, meqë dorëshkrimi që disponojmë është një kopje e origjinalit të Meksit, e realizuar nga një njohës jo i mirë i shqipes, dhe për rrjedhojë krahasimet bazuar në leksik mund të konsiderohen më të sigurta, kemi vjelur në mënyrë thujse shteruese rastet kur Grigori ndryshon fjalë³⁰ (e më rrallë rendin e fjalëve apo trajtat fonetike e gramatikore) të Meksit, të cilat i grupuam si vijon:

Zëvendësim i fjalëve shqip me të tjera fjalë shqip

1/10 ngaha / nga, 1/6 ndë / mbë, 1/7 s' / nuk³¹, 3/4 ata pushojnë / nukë flisnë, 3/11 kuur shihnë / poq' e shihnë, 3/17 domethënë / do me thënë (shih edhe 5/41), 3/21 gjeriitë e tij / njerëzit e tij, 3/22 nxier / kren të paudhëtë (edhe 1/39 nxiir / kren), 3/24 e ndë qoftë ndoonjë mbëretërii të ndahetë ... / e ndë qoftë që të ndahetë një mbretëri..., 4/3 ja, dolli buuku // na, dolli bujku, 4/7 nukë dha farë / nukë zuri bukë, 4/16 vendë zallishte / vënd që qenë gurë, 4/19 lakëmi ... e gënjeshtër / të lakëmuarit' edhe të gënjerit, 4/27 e fara i rrënjosetë / e fara bin, 4/35 atë ditë mbrëmanet le të hidhemi përtejë (deetinë) / e si u er atë ditë ... le të hidhemi mbanë të tejme të detit (shih edhe 5/1), 4/38 pushoi era / mbeti era, 4/40 trëmbarakë / trëmbelakë, 4/41 u tremnë / u frikuanë (edhe 5/15), 5/4 ndoonjë s'munt' ta mbaaj / ndonjë s'mund ta mbante atë, 5/6 u vërsul / u lëshua me vrap, 5/9 sepse / se, 5/11 kope derrash / kope deravet, 5/14 derrarëtë / ata që kullotnë derratë, 5/15 rriij edhe veshurë / rijte veshurë rrobatë,

²⁶ Meksi, Ungjilli pas Markut 8/12: *do të mos ipetë* shënjë kësaaj filie. Grigori, po aty: *do të mos i ipetë* kësaaj filiet nishan. Te Ungjilli pas Mateut, Meksi dhe Grigori e përdorin këtë trajtë në shumë raste (13/14, 16/4, 16/18, 17/20, 18/3, 26/29, 26/35), ndërsa kanë Meksi *nuk* e Grigori *mos* në 12/39, 16/28 dhe 26/33.

²⁷ ajo *do të mos ketë* ujë të pijë (Pedersen 1895, 97). Baba im ishtë mbret i njerëzet edhe imi ishtë i xhinëret, e *do mos të ujdisin* (Pedersen 1895, 187). I kemi hasur edhe në letra të Nolit, shqipja e të cilit ose ruante gjurmë të hershme të të folmeve të Devollit të sipërm ose u ndikua nga kontaktet me korçarë në Egjipt e Amerikë: *do mos* mënonj; *do mos* i shkruanj; *do mos* e bëj kabull; *do mos* më lipsen (Koço 2015, 350, 351, 361, 361). Shtojmë se kjo trajtë dëshmohej edhe në të folmet shqip të Trakës lindore e perëndimore, prej ku u mëkua me shqipen Noli: do miren [martohen] do gëzonen / *do mos* miren, do elmonen (Γιοχάλας 2019: 328).

²⁸ Ama të na shohënjë ashtu, *do mos vëzhdonjë* më gjetëk (Sasse 1991, 494), *do mos dinë* ku të vënë drithëtë (Klosi 2005, 75), kalamboq, pumbeqe, të mbelëdhurë *do mos kenë* (Klosi 2005, 75), Ndë të kërkofsha klumësht, *do mos më japësh?* (Klosi 2005, 203).

²⁹ Meksi, Marku 13/24: Dielli do të erretë, edhe Hënëza *nukë do t' apë* dritënë e saaj. Grigori, po aty: Dielli do të erretë, edhe Hënëza *do të mos apë* dritënë e saj. Te Ungjilli pas Mateut, Meksi ka *nuk* e Grigori *mos* në 12/39, 16/28 dhe 26/33. Krahaso edhe Meksi, Marku 10/43: Ma ndër ju *nukë do të jeetë* kështu. Grigori, po aty: Po ndë juvet *nukë do të jetë* kështu.

³⁰ "... kuptimi është dhënë mirë, por shprehjet nga disa pikëpamje kanë nevojë të ndryshohen", i kishte thënë I.Lowndes-it. (Lowndes për Pinkertonin, Korfuz, 15 janar 1824, Lloshi 2017, 21-22).

³¹ Parafjala *ngaha* zëvendësohet në të gjitha rastet prej *nga*, *ndë* në shumicën e rasteve nga *mbë*, ndërsa vetëm tek Ungjilli pas Markosë gjetëm 38 raste zëvendësimi të *s'* me *nuk(ë)* dhe rreth 80 të tjera të ruajtjes së *nuk(ë)* edhe te Gjirokastriti.

5/19 saa bëri për tyj zoti / sa bëri tek teje zoti, 5/20 sa bëri për të / sa bëri nde ai, 6/13 djaaj / të paudhë, 6/6 çuditej për të paabesllëk të tyre / për pabesllëkn' e ture, 6/20 me gjithë zëmërë / me shumë t' ëmblë, 6/35 e si mënoi / e si shkoi koha, 7/37 të vuvakëtë / vuvëritë, 6/49 vuunë ndërmënd që / u duk nd' ata se, 8/13 paa / përsëri, 8/25 e paa vuri / e përsëri vuri pameta, 8/38 me nder të së jatit tiij / me lëvdim të jatit së tij, 9/1 dekiië / vdekëjë, 9/3 dbora / zbora 9/7 atij të dëgjoni / atij ti digjoni, 9/11 pyesnë atij / pietn' atë, 9/19 birmani atë / birie atë tek meje, 9/33 çë kuvendojë / ç' mendoneshitë, 9/39 të më mallëkojë mua / të flasë të keq për mua, 9/41 se ai që ... / se cilido që ..., 9/41 nukë do të humbasë mundimnë e tij / do të mos humbasë mundimn' e tij, 9/42 t'i varetë një gur mulliri / t'i varetë një mokër mullirit, 9/20 qilisej e shkumon / qilisej tuk' e shkumuarë, 10/1 përtejë Jordhanë / përtejë Jordhanit, 10/6 ndë të nisurë të pllasi / që kur u bë pllasi, 10/27 të kollajshime / të kollajta, 10/43 ma ndër ju / po ndër juvet, 11/11/ sepse u err / sepse koha qe afër mbë t'erturë, 11/21 mallëkove / i dhe nëmënë, 12/24 fuqiinë e Zotit / fuqin' e Perndisë, 12/33 me gjithë kupëtim / me gjithë mënd, 12/34 u përgjegj urtë / u përgjegj mëncurë, 13/26 ndeer/ lëvdim, 13/33 shihni, rriji sgjuarë, edhe falii / vështoni, mos flijni, e lutuni, 14/9 ndë gjithë jetë / ndë gjithë botë, 14/37 i gjen ata fleturë / i gjen ata që flijnë, 14/42 ja / na, 15/1 bënë kshill / u mbëjuadhë, 15/14 kryqase atë / mbërthee atë ndë kruq, 16/14 zëmërë të gurtë / zëmërën e ature të pakthierë

Zëvendësim i fjalëve greqisht me fjalë shqip

1/25 vënd erimii / vënd që nukë qenë njerëz, 2/8 pse silloisii / pse mëndoneni (edhe 8/17, 11/31), 2/17 s'kanë hrii ... ngaha jatro / nukë duhenë jatro, 2/25 pat hrii / pat shtrëngim, 3/32 llauzi i rriij rrotullë / e rijnë turmë rotull atij, 3/35 thelimënë e perdiisë / ato që i pëlqejënë Perndisë, 4/1 shumë turmë ... e gjithë llauzi // shumë turmë ... e gjithë turma, 4/28 protoparë / më përpara (edhe 7/27), 4/30 zoghrafisjëmë / barabarisjëmë, 4/33 u ksijis dhidhahjinë / u flit ature dhidhahjinë, 4/38 nukë vë silloi / nukë të pret tij, 4/39 vuvosu / mos u ndiej, 6/52 silloisurë / kupëtuarë, 7/5 sikundrë është paradhosi i pleqet / sikundrë porsitnë pleqtë, 7/9 paradhosinë / porsinë, 9/47 monosyy / me një si, 9/25 u të prostaks / unë të bëj porsi, 9/41 potiir ujë / kupë ujë, 10/12 bën mihii e (kurvërii) / bën mihji (kurvëri), 11/32 trëmbiishnë llauzit / trëmbejnë turmënë, 12/1 ktisi pirgho / dërtoi kullë, 12/1 rrëmoi patitiir / rrëmoi shkelës, 12/33 gjithë thimiamatë / gjithë dhurëtitë, 12/38 të hjeretisura / të përshëndetura, 13/7 akoma s'është / s'është edhe, 13/19 ktisi Perdia / bëri Perndia, 14/20 ablladhë / kupë, 14/31 ndë goftë hrii / nd'u dashtë, 15/17 porfirë / robë të kuqe, 15/33 skotadh / erësirë

Zëvendësim i fjalëve shqip me fjalë greqisht

3/5helmonej mbë verbërii të mëndet tyre / i eleimonisej për të verbuarit e zëmërësë ture, 6/24 kryetë e Joan Pagëzeeshitë / e Joan Vaptistiut, 7/1 shkreesitë / ghramatejtë, 6/21 zotërinjtë / arhondët, 9/43 ndë zjarr të pashuarë / ndë zjar të pasosurë, 11/17 i pson / i dhidhaks, 11/17 shpellë / shpille, 13/1 prishetë / gremisetë, 16/15 rrëfeni Ungjillë / qiriksnii Ungjillë

Zëvendësim i fjalëve greqisht me fjalë greqisht

3/19 atë që e prodhosi / paradhosi, 6/49 është fandazmë / është fandasi, 9/18 i bie zalii / i bie dhilë, 13/7 edhe telloa (sosië e jetësë) akoma s'është / s'është edhe të sosurit e jetësë, 13/10 do të dhidhaksetë / qiriksetë Ungjilli, 14/2 ndë llauz / ndë llao, 14/44 prodhoti / ai që e paradhosi atë

Zëvendësim i fjalëve greqisht me fjalë turqisht

4/38 mbë një prosqefalë / mbi një jastëk, 5/26 jatronjë / xherahë, 4/37 qimatë / tallazetë, 6/17 filaqii / hapsanë (edhe 6/28), 15/6 të filaqisurë / të hapsosurë, 6/19 i kish zili / kish inat mbë të, 7/28 trapezë / sufra, 8/3 do t'u bjerë zalii / do të bajalldisjënë, 10/21 thisavro / hazine, 10/24 sa dhiskolo / sa zahmet, 10/33 ndë filii të tjera / ndë milete të tjera, 12/1 ktisi pirgho / dërtoi kullë, 12/40 me profas / gjoja, 14/51 sendon / çarçaf, 15/16 taghmënë / biliknë

Zëvendësim i fjalëve turqisht me fjalë greqisht

7/4 legenëvet / ksestravet (edhe 7/8)

Zëvendësim i fjalëve turqisht me fjalë shqip

Zëvendësim i fjalëve shqip me fjalë turqisht

2/13 paa / pagjene, 3/6 bënë kshill / bënë mushavere, 4/22 ndë shesh / mbë mejdan, 6/6 vij rrotullë fshatëratë / gjezdiste rotullë fshatëravet, 6/22 ndë mësallë / ndë sufra (edhe 12/39), 8/8 çporta / zimbile, 8/11 shënjë / nishan, 13/4 shënji (nishani) / nishani, 8/12 do të mos ipetë shënjë kësaj filie / do të mos ipetë kësaj filiet nishan, 8/36 gjithë jetënë / dinjanë (shih edhe 13/19), 10/24 shpëresënë mbë gjë / omuthnë ndë gjë, 13/31 orë / sahat, 14/65 t'i mbulojmë kryetë / të mbulojmë suratin e tij, 15/39 kundreq / karshi, 16/12 jatër figurë (të paarë) / tjetër surat, 16/16 ndë gjithë njerëzit / ndë gjithë dinja

Pasqyrat e mësipërme mund të shqyrtohen nga disa anë dhe po e fillojmë me faktin se puna kryesore redaktuese e Gjirokastrit lidhet me lëndën e mirëfilltë (sipas këndvështrimit të sotëm) të shqipes, ndërsa është për t'u theksuar se te përkthimi i Ungjillit pas Markosë nuk kemi gjetur as edhe një rast të vetëm zëvendësimi të një turqizmi me një fjalë shqipe³², kurse, përkundrazi, lënda e prejardhur nga turqishtja zëvendëson lirshëm fjalë të greqishtes po se po, por edhe të vetë shqipes! Nga ana tjetër, vërejmë se fjalë të greqishtes u zënë vendin fjalëve të tjera po të greqishtes, sikurse edhe të shqipes, apo fjalë të greqishtes iu lënë vendin fjalëve të shqipes. Po japim këtu disa shembuj tekstesh nga Ungjilli pas Markosë.

2/16

Meksi: E si paanë shkreeditë e farisejtë atë që haaj me tellonë e me gijnahqarë, thoshnë mathitiivet tij, pse ai ha e pii bashkë me tellonë edhe me fajtorë?

Grigori: E si e pan' atë ghramatejtë, edhe farisejtë që hajte bashkë me kumerqarë, edhe gjinahqarë, u thoshnë mathitiivet së tij, pse ha edhe pi ai me kumerqarë edhe me gjinahqarë?

10/24

Meksi: E mathitiitë çuditiishnë për fjalë të tij, ma Iisui paa u tha, djem, saa dhiskolo është të hyjnë ndë mbretërii të Perdiisë ata që kanë shpëresënë mbë gjëë.

Grigori: E mathitiitë çoditejnë për fjalë të tij; e Iisui pameta u përgjegj, e u tha ature: djelm, sa zahmet është të hijënë ndë mbretërii të Perdisë, ata që kanë omuthnë ndë gjë.

11/17

³² Te Ungjilli pas Joanit gjetëm vetëm dy raste, si më poshtë: (Meksi) ... hiqni këto punëra këtejë, e mos bëni shtëpiinë e babait sim shtëpii reshperie / (Grigori) ... *ngrini këto këteje; e mos bëni shtëpin' e babait sim, shtëpi të së shiturit e së blerit*. 2/16 [shih turk. *rençper* 1. Day laborer, laborer; workman. 2. Farm hand; farmer]. (Meksi) Nd' është u që t'ap martirii për vetëhe time, martiria ime s'është e ujdisurë. / (Grigori) *Ndështë unë që t'ap martiri për vetëhe time; martiria ime nuk' është e vërtetë*. 5/31

Meksi: E i pson e u thosh: nuk është shkruarë se shtëpia ime do të thuhetë shtëpii të fali për gjithë fili? Ma ju e bëtë shpellë kusarëvet.

Grigori: E i dhidhaks ata, e u thosh: nuk është shkruarë se shtëpia ime do të thuhetë shtëpi e

Ka ndonjë rregullsi objektive pas këtij mozaiku leksikor apo është thjesht pasojë e qëndrimit subjektiv të Grigor Gjirokastritit? Sigurisht që shijet dhe ndjenja gjuhësore e luajnë një rol³³, por tej tyre ekziston edhe një kuadër historik me të cilin mund të shpjegohet kjo larmi ndërkëmbimesh (të habitshme, me syrin e sotëm) leksikore. Ndër faktorët historikë kryet e vendit e zë fakti se shqipja dhe shqiptarët ndodheshin ende në fazën para-kombëtare të tyre³⁴, çka do të thotë se, pavarësisht përpjekjeve të para për një gjuhë të shkruar të përgjithshme, nuk janë shfaqur ende prirjet e krijimit të bërthamave etnike, me shtrirje më të gjerë dhe kohezion më të madh të “indit” kombëtar, bazuar në kundërvënien “ne” – “ata”, e cila në rrafsh gjuhësor pasqyrohet në kërkesën për leksik të pastër, të “pabastarduar” nga “i atyre”³⁵.

Nga ky vështrim, Maksin, e sidomos Gjirokastritin, e vetmja gjë që i preokupon është të shkruajnë në një gjuhë sa më të kuptueshme e sa më të përgjithshme. Brenda kësaj logjike inkuadrohen

*Së pari, një gjuhë e thjeshtë e kuptueshme nga të pashkollët*³⁶

Baza popullore e gjuhës, dhe veçanërisht e fjalësit të përdorur nga Meksi-Gjirokastriti, është një nga karakteristikat e përkthimit shqip të “Dhjatës së Re”. Te Ungjilli pas Mateut 7/1 dhe 7/2 e njëjta folje e greqishtes (κρίνω ‘gjykoj’) përkthehet me dy mënyra:

Meksi:

1. Mos hiqi ndë gojë të tjerët, as të mos u heqënë edhe juvet.
2. Sepse me ç’lloj gjyqi gjykoni të tjerët ashtu do të gjykonii edhe juu. Edhe me ç’me[t]rë matni të tjerët me të tillënë do t’matij edhe juu.

³³ Për shembull, cila është arsyeja që Grigori zëvendëson një herë fjalën *kopili* me fjalën *hyzmeqari* (20/26) dhe herën tjetër *shërbëtori* me *kopili* (20/27) në Ungjillin pas Mateut?

³⁴ Po të ndalemi edhe vetëm në dy figurat kryesore të lidhura me përkthimin dhe botimin e “Dhjatës së Re”, do të shohim se marrin pjesë të dy në Kryengritjen çlirimtare greke, dhe se, madje, V. Meksi në parathënien greqisht të përkthimit të veprës “Doke të izraelitëve dhe të të krishterëve” (1814) do të shkruajë se “Duke parë dobinë e madhe të tij [të librit], nuk kurseva as mundin në përkthim, as harxhet në botim. Sidomos tani, kur fatmirësisht në shkollat e Greqisë mësohet historia, është mirë që, dy herë në javë, mësuesit t’iu lexojnë nxënësve në formë katekizmi një kapitull të librit në fjalë...” (f. 8). Ky njeri, pasi ka hartuar një gramatikë të shqipes, merr përsipër në tetor 1819 të përkthejë në shqip “Dhjatën e Re” dhe nënshkruan kontratën si V. Meksi (Ex Greece)” (Lloshi et al. 2017, 10).

³⁵ Një kërkesë e tillë, prelude i fazës kombëtare, shfaqet së pari te Veqilharxhi më 1846, më pas te Kristoforidhi më 1860, e deri te Naimi, më 1896, për të arritur te “Albania” e Konicës dhe te “Kalendari Kombiar” i Luarasit. Megjithatë, për hir të së vërtetës duhet thënë se prirje “puriste” janë shfaqur qysh në “Anonimin e Elbasanit” të vitit 1761 (Elsie 1995, shih edhe përmbylljen e këtij punimi). Sa i përket qëndrimit ndaj turqizmeve e përgjithësisht ndaj barrës orientale të shqipes, është për t’u krahasuar trajtimi diametralisht i kundërt i Gjirokastritit, redaktorit të “Dhjatës”, dhe i Vretos, redaktorit dhe ‘pastërtorit’ të “Ervehesë”.

³⁶ “Është e vërtetë se krahasimisht *shumë pak prej këtyre njerëzve mund të lexojnë*, por edhe po të mos përmendim se kështu ata do të nxiteshin për të mësuar, çfarë thesari i paçmuar do të ishte një Dhjatë shqip qoftë vetëm për priftërinjtë e tyre... !” (R. Pinkertoni për Londrën, Vjenë, 28 gusht 1816, Lloshi 2017, 5).

Grigori:

Κεφ. ζ. 7.

1. ΜΗ κρίνετε, διὰ νὰ μὴ κριθῆτε.

2. Διὰ τὴν ὅ, τι λογῆς κρίσιν κρίνετε, θέλετε κριθῆ καὶ ἐσεῖς· καὶ μὲ ἐκεῖνο τὸ μέτρον, ὅπου μετράτε τοὺς ἄλλους θέλει μετρηθῆ καὶ εἰς ἐσᾶς.

Κρίε Εὐτάτης. ζ. 7.

1. Μὸς χίχνι μπεὶ φόγε, τὲ μὸς οὐ χέκεγνε.

2. Σέ ψέ σὶ κούντρε Γιουκόνι, δὸ τὲ Γιουκόνεσι, ἐ δὲ μετ' μάτρε χέ μάντρε, δὸ τοῦ μάτετε ἐδὲ γιούβετ.

Pokështu, folja amfibállw 'mëdyshem' e greqishtes përkthehet si më poshtë:

Meksi, Mateu 21/21: e ndë mos qofi me dy zëmëra (kolandísii)

Grigori:

21. Καὶ ἀπεκρίθη ὁ Ἰησοῦς καὶ εἶπέν τους· Ἐβραῖα σᾶς λέγω. ἂν ἔχετε πίστιν, καὶ δὲν ἀμφιβάλλετε, ὅχι μοναχὰ τὸ πράγμα τῆς συκῆς θέλετε κάμει, ἀλλὰ ἂν εἰπῆτε εἰς τὸ ὄρος ἐτοῦτο· σῆκο, καὶ ῥίζου εἰς τὴν θάλασσαν, θέλει γένει.

νε χερε;
21. Εἰ ζότι Κρίστ οὐ περφεῖχ, ἐ οὐ θὰ ἀτοῦρε· μὲ τὲ βερτέτα οὐ θὸμ γιούβετ, ντὲ πάτζι πέσε, ἐ ντὲ μὸς κίοφι μὲ δι ζέμερα, γιὸ βέτεμε χετὲ χέ οὐ πὲ τὲ φίκου δὸ τὲ κένι, πὸ ἐ δὲ χετὲτ μάλλιτ ντὲ ἰ θέφτζι, γκρέου ἐ πγίερε ντὲ δὲτ, δὸ τὲ κένετ.

...e ndë mos qofi me di zëmëra, ...

E njëjta folje, 7 paragrafe më poshtë përkthehet ndryshe:

Meksi, Mateu 28/17: E si e paanë, ju falë, ma e ca mбенë me dy mëndë.

Grigori:

17. Καὶ αὐτοὶ βλέποντές τον, τὸν ἐπροσκύνησαν· ἀμὴ κάποιοι ἀμφίβαλαν.

17. E si e pánε ἀτὲ, γιὸ φάλλε, ἐ τζᾶ κένε μὲ δι μέντ.

E si e panë atë, ju falë, e ca qenë me di mënt.

Një shembull tjetër: Te Ungjilli pas Markut 6/20, për gr. ακούωντάς τον, ἐκαμνε πολλά, καὶ τον ἤκουε μετὰ χαράς, kemi

Meksi: e si i mbush kokënë ai bën shumë punëra ngaha anë e atij, e e digjon me gjithë zëmëre.

Grigori: e si e mбан vesh, bënte shumë punëra me anë të tij, e edigjon atë me shumë t' ëmblë.

Përdorimi i suksesshëm dhe sistematik i leksikut popullor duket bukur në rastin e fjalës *i paudhë/ të paudhët*, që hasen rregullisht në vend të fjalëve διάβολος dhe δαιμόνια të greqishtes dhe përdoren këtu si eufemizma pas frymës popullore. Fjala *i paudhë* dëshmohet e regjistruar qysh më 1809 në Fjalorin e M. Boçarit si barazvlerëse e κακότροπος 'i pasjellshëm', πονηρός 'dinak, dhelpërak', κακοποιός

‘keqbërës’ (Γιοχάλας 1980, 335), por nuk gjendet në Fjalorin e arvanitishtes të Kupitorit, të hartuar rreth viteve 1870 (Γιοχάλας 2006 B). Haset gjithashtu edhe te “Kodiku beratas”, që daton para shekullit XIX, në trajtat të *paudhmit* (οι άνομοι) 10/16, të *paudhmen* (την ανομίαν) 14/24, të *paudhmetë* (τας ανομίας) 4/7 (Demiraj 2019, 433). Rrënjët e hershme të saj në shqipen dëshmohen edhe nga fakti se e gjejmë në veprën *Ndëlgisa e barisisë të gjith rruzullimit / La spiega della creazione di tutto l’Universo* të arbëreshit Nikollë Keta, hartuar para vitit 1777, siç vlerëson botuesi i saj (Mandalà 2004, LXVII): *ndo gjë të paudhë, ndo gjë çë së isht gjithshejtrī / alcuna cosa corrotta, qualcosa che non sia tutta santa*. (Mandalà *ibidem* 48-49).

Së dyti, greqizmat dhe fjalët nga greqishtja

Prof. Lloshi me të drejtë bën dallimin mes greqizmave të ngulitur e me përhapje më të gjerë në shqipen e sidomos në të folmet toske, me fjalët greke që shfaqen ku e ku, kryesisht nën trysninë e tekstit të origjinalit. Kjo duket qartë kur, siç treguam më sipër, Grigori zëvendëson huazime lokale a efemere prej greqishtes me turqizma më të përhapur e më të ngulitur: *jastëk* për *prosqefalë*, *tallazetë* për *qimatë*, *hapsanë* për *filaqii*, *sufra* për *trapezë*, *hazine* për *thisavro*, etj. Nuk është e rastit që një pjesë e këtyre fjalëve janë integruar tashmë në leksikon e shqipes letrare.

Mendojmë se duhet bërë kujdes me një kategori fjalësh që duken si greqizma a fjalë greke, por që në të vërtetë kanë lindur në truallin e shqipes, e prandaj mund të quhen *pseudogreqizma*. Në fjalorthin që shoqëron librin e Lloshit për përkthim-redaktimin e Meksi-Gjirokastritit (2012, 314-380) mund të konsiderohen si të tilla fjalë si *foverí* ‘kërcënim’ (f. 330), formim retrograd i foljes *foverís*, kjo prej aoristit të gr. φοβερίζω ‘frikësoj’, *piraksí* ‘tundim’ (f. 361), nga tema *piraks-* e aoristit të gr. πειράζω ‘tundoj’ + prapasht. -ί, *skand(h)alí* ‘fyerje’ (f. 368), prej foljes *skandhalís*, kjo prej aoristit të σκανδαλίζω ‘fyej, shtie në ngasje’, *zalí* [‘marrje mendsh’] (f. 380), ndonëse nuk cilësohet si e ardhur nga greqishtja, edhe kjo fjalë është formim prejfoljor nga *zalis-em* < gr. ζαλίζω ‘shkaktoj marrje mendsh’.

Fjala *vreilí* ‘vrasje’ (f. 379) konsiderohet si “fjalë e greqishtes”, por ngaqë greqishtja nuk e ka një fjalë të tillë, ajo ngjan të jetë trajta çamërisht **vrájël*, me shumë metafonik *vréjëla*, që dëshmohet te Grigori (vréjla φόνοι ‘vrasje’ Mateu 15/19, vrejëlatë φόνοι ‘vrasje’ Marku 7/21), shih edhe *vrásël* ‘vrasje’ te Haxhihasani 1971,167. Siç vihet re, ndërthurja e të dhënave prej dy ungjijve na çoi në një zgjidhje më bindëse:

Grigori, Mateu 15/19, *vrejla*

<p>19. Διατί από την καρδίαν εύγαί- νον διαλογισμοί κακοί, φόνοι, μοι- χείαις, πορνείαις, κλεψίαις, ψευδο- μαρτυρίαις, βλασφημίαις.</p>	<p>19. Σε ψέ γκά ζέμερα δάλλενε σιλοϊ τέ κέκία, βρέιλια, μιχίερα, κουρβερίρα, τέ βγιέδουρα, μαρτυρι τέ ρέμε, βλασφημίρα.</p>
---	--

Grigori, Marku 7/21, *vrejëlatë*

<p>21. Διατί ἀπό μέτα ἀπό τήν καρ- δίαν τῶν ἀνθρώπων εὐγαίηουσι κακοί διαλογισμοί, μοιχεύαις, πορνείαις, φόνοι,</p>	<p>21. Σε ψέ πρένταζι γκα ζέμερ' ε' νιέρεζετ, δαλλενε. συλοίτ' ε' κίχια, μο χίτε, κουρβερίτε, ε' βρέγλιατε.</p>
--	---

Në përgjithësi, ndërthurja e të dhënave që na ofrojnë dorëshkrimi dhe botimi, e cila ka për t'u bërë më efikase kur e gjithë lënda të jetë e përpunueshme në kompjuter, na jep dorë për zgjidhjen e problemeve që lindin gjatë transkriptimit të tekstit të Meksit. Një rast të tillë kemi te mbiemri (?) *poliandhis*, që konsiderohet “fjalë e greqishtes me kuptimin ‘dyshues, me disa mendje’ [dhe] haset vetëm te Meksi” (Lloshi 2012, 362), dhe i cili, i kombinuar me foljen *kolandis* ‘tund’ (Lloshi 2012, 340), të dëshmuar tjetërkund (Meksi, Mateu 11/7), me një lexim më të kujdesshëm të dorëshkrimit na çon te një trajtë foljore *kolandísii*: e ndë mos qofi me dy zëmëra (*kolandísii*).

πολιανδισί (κολλανδισί) γιό κηλοκίε τβία

Meksi, Ungjilli pas Mateut 21/21.

Së treti, turqizmat dhe fjalët turqisht

Te Meksi turqizmat janë krahasimisht të paktë dhe elementët fjalëformues nga turqishtja shfaqen shumë rrallë. Grigori duket se ka një raport tjetër me turqizmat e kjo mbase ka të bëjë jo vetëm me formimin dhe rrethanat e jetës së tij, por edhe me faktin se ai dëshiron t'u drejtohet edhe arvanitasve (siç duket edhe nga korrespondenca e BFBS). Po të marrim e të shohim pjesën e Mateut të përkthyer prej tij (nga 21/35 deri në 26/24), do të vëmë re se ai ka përdorur fjalët turke *hazër, asqerët, dert, haraç, hasmërit, pazare, husmeqari, gjinah, ujdisim, kamçi, millet, nishane, sahat, hapsanë, husmet, mushavere, kallaballëk, zahmet, dinia, çanak*, e disa prej tyre (*sahat, hazër, millet*) në mënyrë të përsëritur.

Na duket pak i shpejtuar argumenti se në Janinë pesha apo barra e turqizmave ka qenë më e kufizuar se në viset ku Gjirokastriti i shërbente grigjës së vet. Janina vërtet ka qenë vendtakim i shqiptarëve të ardhur nga anë të ndryshme të Shqipërisë, por s'pushonte së qeni edhe qendër vilajeti, me ndikim të ndjeshëm të turqishtes. “Alipashiada” e Haxhi Shehretit dhe tani së fundi dokumentet e Arkivit të Ali Pashës tregojnë sa i thellë e sa i gjerë ka qenë ndikimi i saj³⁷.

³⁷ Është domethënës fakti se nga krahasimi i fjalorthit të dokumenteve (vëll. IV i Arkivit, 189-300) me fjalorin e turqizmeve të “Alipashiadës” (Kappler 1993, 72-129), vetëm për shkronjën β [v] të greqishtes janë regjistruar mbi 40 fjalë turke që nuk hasen në vargjet e H. Shehretit. Nga ana tjetër, ndër turqizmat e përdorur prej Grigorit në përkthimin e krerëve 21/35-26/24 të Ungjillit pas Mateut, vetëm fjala *çanak* nuk haset te “Alipashiada”.

4. Nga ungjilli në ungjill

Përkthim-redaktimin e Ungjillit pas Markosë Grigori e ndërmerë pas përvojës me redaktimin dhe përkthimin e Ungjillit pas Mateut (1824). Sa është pasqyruar kjo në tekstin përfundimtar të 1827-s?

Le të shohim si operon ai me fjalët në kllapa, që gjen te dorëshkrimi i Meksit. Midis çifteve sinonimike *kupë (mashtrek)* (Marku 6/25), (*çardhak*) *odë* (Marku 14/15), *Dhiathiçit të rii (dhiatësë së ree)* (Marku 14/24), ai zgjedh fjalët *kupë, çardhak dhe dhiatësë së ree*, pra duket më i sigurt në vendimet që merr dhe zakonisht i shmang kllapat³⁸. Sa për kriteret e përzgjedhjes, ato duket se janë subjektive e jo gjithnjë njëkajshe, sepse, f.v., te Marku 6/28 e mban të pandryshuar fjalën *mashtrek*, ashtu siç e ka dsh i Meksit, kurse tre paragrafë më sipër e ka zëvendësuar me *kupë*. Po ashtu, te Marku 9/48, për *krimbi i atyire nukë (sosetë) des*, shkruan *krimb' i ture nukë vdes*, ndërsa te Marku 16/16 *do të sosetë (shpëtojë)* bëhet *do të sosetë*, etj. Një rast tjetër është kur përdor një fjalë të tretë, të ndryshme nga çifti sinonimik i Meksit: *dheu vetiut protoparë nxier (vllastis) baar* bëhet *vetiut dheu pjell, më përpara bar* (Marku 4/28), etj.

Duhet thënë, megjithatë, se zëvendësimet nuk janë përherë të goditura:

Ungjilli pas Markut 8/11

Meksi: nisë ... t'i kërkojnë prej si shënjë ngaha qelltë...

Grigori: nisë ... të kërkojnë nga ai nishan nga Qielli...

Le të shohim po ashtu çfarë ndryshimesh vihen re kur kemi (pothuaj) të njëjtin tekst tek dy ungjij të ndryshëm.

Ungjilli pas Mateut, 21/33

Meksi: Jetërë paravolii digjoni. Një njerii zot shtëpie, e ai (fitepsi) vuri një veeshtë, e e thuri me gardhe e rëmoi ndë të patitiir, e stisi ndë të pirgo, e e dha atë buuqet, e iku.

Grigori:

33. Ἀλλὴν παραβολὴν ἀκούσατε. Ἦτον κάποιος ἀνθρώπος οἰκοκύριος, ὁ ὕποιος ἐφύτευεν ἓνα ἀμπέλι, καὶ τὸ ἔφραξε τρυγύρω, καὶ ἔσκαψεν μέσα εἰς αὐτὸ ληνὸν, καὶ ἔκτισε πύργον· καὶ τὸ ἔδωκεν τιμησάριχον εἰς τοὺς γεωργοὺς, καὶ ἐμίσευσε·

33. Ἰγιέτρ̄ παραβολὴ διφιόνι, νιῆ νιερί ζὸτ ἔτεπίετ, ἔ αἰ θουῆρι (φυτέ-ψι) νιῆ βέῆτε, ἔ ἔ θουῆρι ἀτῆ με φάρδε, ἔρεμού μπῆ τῆ πατητιῆ, ἔ ἔ τισι μπῆ τῆ πύργω (κούλλῆ) ἔ ἔ δά ἀτῆ ντῆ κούῆγκ, ἔ ἔκου.

Grigori: Tjetër paravoli digjoni, një njeri zot shtëpiet, e ai vuri (fitepsi) një vështë, e e thuri atë me gardhe, e rëmoi mbë të patitir, e stisi mbë të pirgho (kullë) e edhe atë ndë bujk, e iku.

Ungjilli pas Markosë, 12/1

³⁸ Te përkthimi i Mateut Grigori ka Nuk' është *mathiti (kallfë)* më i madh se *dhaskali (ustai)* tij (10/24) dhe Me aft i është *mathitiut*, të bënëti si *dhaskali* tij (10/25), çka tregon se sinonimi në kllapa shërben si një sqarues a përforcues i fjalës prijëse.

Meksi: E nisi t'u flit atyre me paravolii, e t'u thosh: një njeri fitepsi vëështë, e i bëri garth, e rëmoi patitiir, e ktisi pirgho, e u dha buuqet, e iku lark.

Grigori:

<p>κ. Καὶ ἄρχισα μὲ παραβολαῖς νὰ τοὺς λέγῃ· ἓνας ἄνθρωπος ἐφύττευεν ἀμπέλι, καὶ τὸ ἐτρέφωσεν, καὶ ἐσκαψεν εἰς αὐτὸ πατητῆρι, καὶ ἐκτίσεν πύργον, καὶ τὸ ἔδωκε τιμησιάρικον εἰς τοὺς γεωργοὺς, καὶ ἐμίσησεν.</p>	<p>κ. E nisi tou flit atoure me parabolira, e tou thos' eis nieri fitepsi vesishte, e i beri garth, e ktsi pirgho, e u dha buuqet, e iku lark.</p>
--	--

E nisi tu flit ature me paravolira, e tu thosh: një njeri fitepsi vështë, e bëri rotull gardh, e rëmoi shkëlës, e dërtoi kullë, e u adha bujqet, e iku larg.

Po japim për krahasim edhe përkthimin toskërisht të Kristoforidhit, të v. 1879:

Ungjilli pas Mateut, 21/33

Dëgjoni një tjetërë paravoli: Një njeri ishte zot shtëpie, i cili mbolli një vështë, edhe e thuri me garth, edhe rëmoi mb' atë një tirë, edhe ndërtoi një pirk: edhe e dha atë ndër bujq, edhe iku ndër dhe të huajë.

Ungjilli pas Markut, 12/1

Pasandaj zuri t'u thot' atyre me paravolia, Një njeri mbolli një vështë, edhe e thuri me garth, edhe rëmoi një tirë, edhe ndërtoi një pirk, edhe e dha ndër bulqë, edhe iku ndër dhe të huaj.

Në ç' masë ndërhyjnë redaktori në tekstin e përkthimit të Meksit? Bën ndërhyrje të pjesshme apo synon thelbin e gjërave? Nga krahasimi del që Grigori ka ndryshuar thujtje çdo paragraf të Meksit, dhe se ky ndryshim prek të gjitha nënsistemet (fonetikën, morfologjinë, sintaksën, leksikun), por, sipas rastit, është i një shkalle më të vogël a më të madhe. Kolegu Gëzim Gurga (2019, 161-165) e ka rrahur këtë çështje dhe me të drejtë vëren se, me kritere filologjike, botimi integral i “Dhjatës së Re” i vitit 1827 mban emrin e redaktorit G. Gjyrokastri dhe nuk përcjell dëshirën e fundme të përkthyesit të parë, V. Meksi³⁹. Një shënim në faqen 9 të Raportit III të Komitetit të Shoqërisë Biblike Joniane⁴⁰ (shih Shtojcën) flet në të mirë të versionit se Grigori i qe vënë punës për një përkthim të ri, por fjala *επιστασία* ‘përkujdesje,

³⁹ “In ragione di quanto dimostrato, si può concludere affermando che oggi disponiamo di due traduzioni del Nuovo Testamento: quella dell’edizione a stampa del 1827 e quella del ms. inedito di Meksi. La paternità di quest’ultima è certamente attribuibile a Meksi, mentre quelle delle due edizioni a stampa del 1824 e 1827 con molte probabilità sono opera di più mani, benché possano entrambe essere riferite alla volontà di Grigorio, dal momento che furono da questi revisionate per la stampa.” (Gurga 2019, 165).

⁴⁰ “Një përkthim shqip i Dhjatës së Re i kryer prej të ndjerit Doktor Meksi, vendas prej Shqipërie, iu dërgua Shoqërisë nga i përnderuari zoti Leeves, bashkëpunëtor i Shoqërisë së lartpërmendur në Kostandinopojë. Ai u bë shkak që Komiteti Jonian të ndërmarrë një përkthim të ri të përsosur të Dhjatës së Re, për të cilin po flasim, nga dora e Mitropolitit të Eubesë Grigorit, vendas edhe ky prej Shqipërie.”

redaktim' e vendosur në ballinën e botimit të v. 1827 sikur e dobëson argumentin⁴¹. Nga ky këndvështrim, mund të flitet për dy përkthime të ndryshme të dy autorëve të ndryshëm. Nga ana tjetër, duke krahasuar tekstet e Meksit dhe të Gjirokastritit, por edhe nisur nga logjika e gjërave, dalim në përfundimin se Gjirokastriti ka ecur në gjurmët e Meksit, duke ndërhyrë, sipas rastit, në shkallë të ndryshme.

Sa për debatin lidhur me autenticitetin e kopjes së dorëshkrimit të përkthimit të Meksit⁴², jam i bindur se, bazuar në kritere filologjike, ky tekst, me numrin e madh të inkonsekuencave që e karakterizojnë (shih shembujt e dhënë në Kreun 4/19-21 të Ungjillit pas Joanit), nuk mund të jetë shkruar ose kopjuar prej një personi që e njihte mirë shqipen, e që madje hartoi një gramatikë të shqipes. Kërkimet e mëtejshme arkivore për jetën dhe aktivitetin e Meksit mbase do të hedhin dritë në këtë pikë të errët.

Shembujt e mëposhtëm, nxjerrë nga përkthimi i Ungjillit pas Joanit, ngjajnë si hallka të një *continuum*-i, në njërin krah të të cilit ndryshimet janë thuajse të papërfillshme, ndërsa në tjetrin bëhen gjithnjë e më të thella:

E ndë mos besoni mb' atë që kaa ai shkruarë, qysh do të besoni mbë fjalë të mia?/ *E ndë mos besoni mb' ato që ka ai shkruarë, qish do të besoni mbë fjalë të mia?* (Joani 5/47)

Se ndoonjë që do ta mburjënë bota, s'i bën punëtë e tij fshehura; ndë bën të tilla punëra, dëfto vetëhenë ndë botë./ *Se ndoonjë që do ta mburjënë bota, s'i bën punët' e tij fshehura; ndë bën të tilla punëra, dëfto vetëhenë tënde ndë botë.* (Joani 7/4)

E thosh: ndajë u thaçë juuve, që nukë munt të vijë njerii tek u, ndë mos i qoftë dhënë atij ngaha babai im. / *E thosh: andaj u thaçë juvet, se nukë mund të vijë njeri tek u, ndë mos i qoftë dhën' atij nga babai im.* (Joani 7/65)

Ndonëse u thash që ju do të disni mbë fajë tuaj; sepse ndë mos besofi që u jam, do të disni ndë fajë tuaj. / *Andaj u thaçë juvet, që do të vdisni mbë faje tuaj; sepse ndë mos besofci që unë jam, do të vdisni mbë faje tuaj.* (Joani 8/24)

...s'i ke[j] ardhurë orë e tij. / *...nukë kish ardhurë edhé sahat' itij.* (Joani 8/20)

Në përgjithësi, Grigori i qëndron më besnik origjinalit:

Ju përgjeq Iisui e i thotë atij, me të vërtetë me të vërtetë u thom juuve, çirido që nukë leen përsërii nukë munt të shohë mbëretëriinë e Perndiisë./*E ju përgjegj Iisui, e i thot' atij: vërtet*

⁴¹ Le të shënojmë me këtë rast se, sikurse është shkruar së fundi, Grigori kreu “përshtatjen gjuhësore të tekstit të shenjtë në dy shtylla paralele në çdo faqe, [e cila] i shërben një qëllimi të caktuar që, përveç shqipes, ka të bëjë edhe me greqishten e re të përbashkët, të përdorur në atë kohë.” (Πυλαρινός 2016: 215). Kështu, roli i përkujdesësit/redaktorit të botimit pati qenë i dyfishtë: kontrollonte dhe ndreqte nga ana teologjike përkthimin shqip të Meksit, duke kufizuar parafrazimet dhe shpjegimet në kllapa, por edhe përmirësonte tekstin greqisht për ta bërë më të kuptueshëm. Shih edhe rregullin e parë të Shoqërisë Biblike Joniane: “I vetmi qëllim i sistemit është, që përhapja e Shkrimit të Shenjtë, pa asnjë shënim, apo koment, të bëhet, sa më shumë, te banorët e Korfuzit dhe te bashkëkombësit e tyre.” (Αναφορά 1825: 3).

⁴² “In May 1823 Mr. Leeves was directed to send a copy of the Gospel of St. Matthew in Albanian to Corfu, to be printed there under the direction of the Jonian Bible Society.” (Sipas Gurga 2002-2005, 10, note 15; information from Platt’s “History of translations”, vol. 5th, Bible Society Archives, microfilm number CM07391 p. 3).

vërtet të thom tij, ndë mos leftë njeri sipërit [ἀνωθεν], nukë mund të shohë mbretërin' e Perndisë. (Joani 3/3)

I thotë atij Nikodhimi, qysh munt kuurrë një njeri të leejë përsëdyjti kur është plak; munt vallë ai të hyjë përsëdyjti ndë bark të mëmësë tij, e të leejë përsërii? / I thot' atij Nikodhimi, qish mund kurrë një njeri të lejë për së ditit kur është plak? Mos mund ai të hijë për së ditit ndë bark të mëmësë tij, e të lejë përsëri? (Joani 3/4)

Mos u çudit ndë të thashë tyj, që është hrii që të lehesh përsëdyjti. /Mos u çudit ndë të thaçë tij, që duhaetë të leheni juvet sipërit [ἀνωθεν]. (Joani 3/7)

Gjirokastriti është më analitik dhe më “ballkanik” për sa i përket dublimit të kundrinave:

çifutë e kërkojnë ta vritnë. / e kërkojn' atë çifutë ta vritnë. (Joani 7/1)

e diij Iisui që heriet çitë janë ata që nukë besojnë, e çiri duaj ta prodhos. / Iisui e dij që krie herësë cilëtë jan' ata që nukë besojnë, edhe cili ish ai që duaj ta paradhos atë. (Joani 7/64)

E këta të dërguaritë qenë ngaha erësi i Farisejet. / E këta që qenë dërguarë ishnë nga éresi i Farisejet. (Joani 24/1)

Ndryshime vihen re edhe në rendin e gjymtyrëve:

Fjala ish bashkë me Perndinë / Fjala ish me Perndinë bashkë (Joani 1/1)

ditënë e tretë / të tretënë ditë (Joani 1/2)

kyj ish ai që thashë për të / kuj ish ai që për të thaçë (Joani 1/15)

E gjithë na muarm ngaha ajo që i tepëron atij, e dhurëti ndaj dhurëtiisë lashtë. / E nga ajo që i tepëron atij, muarm të gjithë nevet, e dhurëti ndaj dhurëtisë. (Joani 1/16)

Ndoonjë s' e paa kuurrë Perndinë; i biri i vetëmë, që është ndë gjii të babait, ai na e cbuloi. / Perndinë ndonjë nuk' e pa kurë, i vetëmi Bir që është ndë gjii të babait, ai na e zbuloi. (Joani 1/18)

I thanë më pasandajë atij çiri jee? Që të përgjegjemi atyre që dë[r]guanë neeve? Ç' thua ti për vetëhe tënde? / Më pastajë i than' atij: cili je? Që të përgjegjemi mba ta që na dërguanë navet? Ç' thua për vetëhe tënde? (Joani 1/22)

Nathanaili ju përgjeq, mund të dalë punë e mirë ngaha Nazareti? Filipi i thotë ea, e shih. / E i thot' atij Nathanaili: nga Nazareti mund të dalë ndonjë emirë? I thot' atij Filipoi: eja, e shih. (Joani 1/47)

E u thosh adha Iisui atyre çifutet që panë besuarë mbë të: do të jiini mathitii të miitë të vërtetë ndë ruajtëshi fjalëtë e mia. / E u thosh adha Iisui ature çifutet që panë besuarë nde ai: ndë ruajçi fjalët' emia juvet, do të jini mathitit' emi të vërtetë. (Joani 8/31)

E ish dit' e shëtun kuur bëri lucënë Iisui, e i hapi atij syytë. / E kur bëri lucënë Iisui, e i hapi atij sitë, ish dit' e Shëtunë. (Joani 9/14)

Gjuha e Meksit është më afër ligjërimit popullor, ndërsa Grigori është më libror:

Qe një njeri ngaha eresi i farisejet, Nikodhim ëmërë i tiij, ngaha të parëtë e çifutet./ *E qe një njeri nga eresi i Farisejet, që quhaej Nikodhimo, nga të parët' e Çifutet.* (Joani 3/1)

Pas këtyre vate Iisui përtejë deetinë e Ghalileesë, doo thom të Tiveriadhë[së]./ *Pasandaj vate Iisui përtej detit së Ghalileesë, do me thënë të Tiveriadhësë.* (Joani 6/1)

(E këtë e thosh ta dhoqimas atë, sepse ai e diij atë që qe për të bëërë.)/(*E këtë e thosh për të dhoqimasur' atë, se ai e diij atë që duaj të bën.*) (Joani 6/6)

... u shtëmëng paa ndë mal vetëmë filli. / *...u shtëmëng pa ai ndë mal vetëmë.* (Joani 6/15)

E deeti nakatosej sepse fryyn eerë e madhe. / *E deti nakatosej, sepse frynte er' emadhe* (Joani 6/18)

Përtejë deetinë / përtej detit (Joani 6/22, 6/25)

Tashti Moisiu ndë nomt na kaa porësiturë, ... / *E Moisiu na ka porsiturë navet ndë nom, ...* (Joani 8/5)

Që kuur është jeta jetë, nuk' është digjuarë të thonë, që të keetë hapurë ndoonjë syytë e atij që kaa lerë i verbërë./ *Që kur është jeta, nuk' është digjuarë të thonë, që të ketë hapurë ndonjë sit' e atij që ka lerë i verbërë.* (Joani 9/32)

E ndajë e pushtruanë rrotullë çifutë, e i thoshnë, ndë jee ti Krishti, thuajnae neeve ballë faqeza./ *E pushtruanë dha atë çifutë rotullë, e i thoshn' atij: ngjera kur mban Shpirtinë tonë varturë? Ndë je ti Krishti, thuajna nevet faqeza.* (Joani 10/24)

I thotë adha Martha Iisuit, Zot, të jeshe këtu, nukë më vdis vëllai. / *I thotë dha Martha Iisuit, Zot, të jeshe këtu, nukë duaj të vdis vëllai im.* (Joani 11/21)

5. Mes traditës dhe risisë

Qysh në paragrafët e parë të Mateut (3/14) Meksi dhe Grigori na befasojnë me përdorimin e disa trajtave përemërore, që studiuesit i kanë cilësuar unikale⁴³, e që mbeten objekt diskutimi. Te Ungjilli pas Mateut 3/14, p.sh., gjejmë

Meksi: E Joani e mbodhis e i thosh: unë kam shtrëngim që të pagëzonem prej teje, e ti vjen të pagëzonesh **ngaha meeje**?

Grigori: Po Joani e mbodhis atë e i thoshte: unë kam shtrëngim të pagëzonem prej teje, e ti vjen **tek meje**?

Gr. e re: Αμή ο Ιωάννης τον εμπόδιζε λέγοντας· εγώ έχω χρεία να βαπτισθώ **από εσένα**, και συ έρχεσαι **εις εμένα**;

Gr. e vjetër: ὁ δὲ Ἰωάννης διεκώλυεν αὐτὸν λέγων· ἐγὼ χρεία ἔχω ὑπὸ σοῦ βαπτισθῆναι, καὶ σὺ ἔρχῃ **πρὸς με**;

Nga analiza e tyre funksionale dhe strukture nuk vihen re gjurmë ndikimesh të greqishtes e si pasojë shtrohet pyetja nëse kemi të bëjmë me elementë të idiolektit të Meksit e të Grigorit apo me një dukuri të padokumentuar të të folmeve të Labovës së Rrëzës e të rrethinave të Gjirokastrës. Nisur prej trajtave dhe përdorimeve që

⁴³ “nuk i kam hasur asgjëkundi tjetër në shqipe”, shënon kolegja A. Omari (2000, 49).

parashtrojmë në mënyrë të përmbledhur më poshtë jemi të prirur të besojmë se janë formime analogjike mbi bazën e rrjedhës *meje, teje, jush*, etj.⁴⁴

Tek Ungjilli pas Mateut i Meksit gjetëm *ngaha meeje* (7 herë), *ngaha teeje* (4), *ngaha jush* (1), kurse te Grigori (1827) gjetëm trajtat *nga meje* (7), *nga teje* (8), *tek meje* (9), *tek teje* (6), *prej teje* (4) përpara *teje* (3), *pas teje* (2) dhe *më teje* (2). Po kështu, te teksti i Grigorit u venduan ndërtimet *erdhë tek ai, u qas tek ai, erdhtë tek meje, erdhm tek teje, afëronetë tek meje, të vijnë tek meje, u dërguanë tek teje, tek meje e bëtë, thom tek tii, vij/vjen tek tii, sa herë të fëjejë tek u vëllai im, mos qoftë kjo tek teje*, etj.

Tek Ungjilli pas Markosë këto lloj përdorimesh hasen më pak (Meksi: *ngaha meeje, ngaha teje, mërgo ngaha meeje këtë potir, ngaha jush, ngaha ai, prej si, sa bëri për tyj zoti, të vijnë tek u, janë tek ti*; dhe Grigori: *nga meje, nga teje, nga jush, sa bëri tek teje zoti, të vijënë ndek u, janë tek ti, nga ata, prej sij*, etj.).

A nuk bie ndesh përdorimi i këtyre trajtave me kriterin e kuptueshmërisë që ndjekin Meksi dhe Grigori? Mendojmë se, duke qenë trajta të formuara analogjikisht, ato nuk janë të pakuptueshme për njohësit e shqipes⁴⁵.

6. Përmbyllje

Mund të hiqet një paralele mes përvojës që qe grumbulluar pas përkthim-redaktimit dhe botimit të Ungjillit pas Mateut më 1824 dhe dijës që është grumbulluar aktualisht pas daljes në dritë të librit të Xh. Lloshit “Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit” (2012), kurorëzim i një pune 40-vjeçare, por edhe pikënisje për zgjerim e thellim të studimeve në këtë fushë. Moti i mbarë 1824, i botimit të Ungjillit pas Mateut, u pasua nga moti i madh 1827, i daljes në dritë të “Dhjatës së Re”, sikurse moti i afërt 2012 duhet pasuar nga një i ngjashëm me motin e largët të shtypjes së “Dhjatës”.

Ideja është për një botim gjuhësor e filologjik me katër kolona paralele, e para e të cilave do të përmbajë tekstin greqisht, e dyta përkthim-redaktimin shqip të 1827-s, e treta transkriptimin e e kopjes së dorëshkrimit të Meksit sipas alfabetit të sotëm të shqipes, e katërta transkriptimin e tekstit shqip të 1827-s, po me alfabetin e sotëm të shqipes, shoqëruar të gjitha këto me shënimet gjuhësore e filologjike që do të burojnë nga shqyrtimi⁴⁶ i brendshëm dhe i jashtëm i kolonave të Meksit e të Gjirokastritit. Krahas këtyre do të jetë edhe një kolonë virtuale, me tekstin e digjitalizuar të kopjes së dorëshkrimit të Meksit, aneks i domosdoshëm i librit, si dhe lista e përgjithshme e fjalëve të përdorura në tekste, shoqëruar me sqarimet e nevojshme.

⁴⁴ “... ka të ngjarë të jetë një paralelizëm funksional në analogji me ndërtimet me parafjalën prej.” (Omari, po aty).

⁴⁵ Është me interes të vihet në dukje se ky përdorim haset edhe te Kamarda, te përkthimi “Fyletia e Arbënore” ... i veprës së Dora D’ Istrias: Munse *ëndonjë jatërë do bönjë më mirë ka meje* ... (Camarda 1867, Prekalëzimë X).

⁴⁶ Shembulli i foljes *çoj*, i përmendur më sipër, është një rast domethënës i nevojës dhe i rëndësisë së kësaj lloj kqyrjeje të materialit.

Dy kolonat e para i kemi të gatshme prej botimit të 1827-s, kolonën e tretë e nisi Xh. Lloshi dhe ka dëshirën ta vazhdojë autori i këtyre radhëve, ndërsa të katërtën e ka përgatitur Th. Qendro⁴⁷.

Ka për të qenë një punë bukur e madhe dhe fort e vlefshme, bazuar në përvojën e deritashme dhe e pasuruar me gjetje e qasje të reja, të pritshme e të mirëpritura gjatë eksplorimit të pjesëve gjer më sot të "pashkelura" të veprës së jatro Meksikojt dhe të mitropolitit Grigor Stefo Gjirokastriti.

Tej këtyre, sikurse e theksuam me raste të ndryshme në hyrjen dhe shënimet e këtij punimi, realizimi i botimit në fjalë do të na ndihmojë të kemi një pamje më të plotë e pa paragjykime për të ashtuquajturin "Qarku ortodoks i Shqipërisë jugore" (Çabej 1994, 55), i cili, së bashku me "Qarkun katolik të Shqipërisë Veriore" dhe "Qarkun italo-shqiptar" mund të quhen edhe "qarqe *parakombëtare*, meqë mënëfund derdhen të gjitha në lumin e literaturës nacionale të shekullit XIX". (Çabej *ibidem*). I njëjti autor vëren pak më lart se "Këto qarqe veprojnë krejt pavarësisht njëri nga tjetri, dhe sado pothuaj të një kohe, veprojnë çuditërisht pa njohur fare shoqi-shoqin".

Këto mendime të Nestorit të gjuhësisë shqiptare mund të shtrihen për mbarë prodhimin intelektual të atyre qarqeve, të shprehur shpesh jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në gjuhët dhe alfabetet e traditës konfensionale të tyre. Të ndërgjegjshëm se trajtimi shterues i kësaj teme është objekt i një studimi të posaçëm, po ndalemi në *paradigmën* e përkthimeve shqip të teksteve të besimit ortodoks, që i paraprinë "Dhjatës së Re" të 1827-s.

Studiuesi R. Elsie, në punimin model të tij për *Anonimin e Elbasanit* (Elsie 1995) nënvizon se "The eighteenth-century Elbasan Gospel Manuscript, fifty-nine pages of biblical texts in a southern Geg dialect of Albanian, written in an original alphabet, is of significance to the development of Albanian culture for a number of reasons. *The work would seem to offer the oldest example of an original Albanian alphabet, i.e. the first attempt ever made to create a writing system specifically designed for the Albanian language.* The manuscript also *contains the first sizeable biblical translations from Greek into Albanian as well as the earliest original Albanian prose text from the Orthodox milieu.* Given the paucity of Albanian-language writing in the eighteenth century, the Elbasan Gospel Manuscript is of significance both to the development of early Albanian literature and to our knowledge of the Albanian language in that period." dhe shton se "Evidence would seem to indicate that *the Elbasan Gospel Manuscript was the work of Gregory of Durrës (d. 1772), remembered as one of the most learned men of his age.* His Albanian-language Bible translations have long been considered lost. *The author's invention of an original alphabet, his careful avoidance of foreign loanwords throughout the text, and possibly his conscious utilization of a supra-regional dialect are also of significance. They offer sufficient proof that a spirit of national awareness existed among the much-oppressed and vastly underdeveloped Albanians over a*

⁴⁷ Në saje të punës së tij, studiuesit kanë tashmë në duar tekstin e plotë të "Dhjatës së Re", transkriptuar me alfabetin e sotëm të shqipes dhe shoqëruar me shënime sqaruese.

century before the Albanian national movement began to take form.” (marrë nga Abstract-i i punimit të autorit, nënvizimet janë tonat Dh.Q.Q.)

Ne do të shtonim se Grigori i Durrësit lidhej me qarqet kulturore të Voskopojës, u pat shkolluar aty me mësues Joan Halkeun dhe është autor, ndër të tjera, i një *Akoluthie* të shkruar në greqishten kishitare kushtuar neomartirit Nikodem të Beratit, botuar në shtypshkronjën e Voskopojës më 1842 (Peyfuss, 116-117), deri më sot pak e studiuar, pak e komentuar dhe sigurisht e papërkthyer⁴⁸. I shndërruar në simbol të qëndresës kundër islamizimit masiv të shqiptarëve ortodoksë, Nikodemi pranon të flijohet vetëm e vetëm që të rikthehet në grigjën e krishterë, nga e cila u shkëput për ca kohë. Po marr nga teksti i Akoluthisë vetëm dy fragmente: Πάσα των Αλβανών η χώρα χορευέτω [Mbarë vendi i shqiptarëve të marrë vallen] ... [ngaqë me flijimin tënd] Εξέλαμψας όστις ως αστήρ φωτεινός τη γη των Αλβανών [ndriçove si yll vezullues dhéun e shqiptarëve.]

Një tjetër elbasanlli, Kostandin Anastas Nelko-ja, përkthyes i konsullit austriak në Janinë, në fund të viteve 1840, shkruan një letër greqisht për Athanas Armodhin, mësues i greqishtes në Korçë, dhe ndër të tjera bën fjalë për ... *Teodor Haxhi Jakovi[n]*, i lindur rreth viteve 1750 në Elbasan, mësues i shkëlqyer, [që] shkoj në mbarë viset e Ilirisë [gegërisë] dhe të Shqipërisë dhe mblodhi lëndë fjalësh të çmuara, e kësisoj krijoi një gjuhë të përbashkët të shqipes të cilën e shkroi i pari duke përdorur shenjat që radhitim më poshtë. Ai përktheu *Dhjatën e Vjetër dhe Dhjatën e Re në dialektin kryelartë e hijerëndë të ilirishtes [gegërishtes]. –Punët e tij i përpiu flaka në kohë kolere, por disa pjesë të tyre arritën të shpëtojnë duke ngjallur admirim për begatinë e fjalëve, për hirshmërinë e stilit dhe dhuntinë natyrore të autorit si krijues fjalësh që nuk ekzistonin në dialektet. Kështu [kemi] perëndiljemë [perëndilemë] për θεοτόκος, barquelján [barkelan] për μακρόθυμος, mirëbám [mirëbam] për ευεργέτης, dorëschcréssë [dorëshkresë] për χειρόγραφον, dheschcréssë [dheshkresë] për γεωγραφία, dhemátje për γεωμετρία, lart-kjénminë [lartqenminë] për ύπιστον ον, dhe për γη, bóhtë [botë] për κόσμος (materialisht dhe moralisht), toque [toke] për στερρεά, schéquul [shekull] për οικουμένη, ndëdiéllë [ndëdiellë] për οφήλιος . (Qirjazi 2015).*

Nëse Teodor Haxhi Jakov-i i K. Nelkos është, pas gjasash, i njëjti me Todër Haxhifilipin apo Dhaskal Todrin, është interesante të vihet në dukje që ky ka ndër kallur në botimin II të “Akoluthisë së Gjon Vladimirit” (Venedik, 1774)⁴⁹ një vjershë ku i kërkohet Shën Gjonit, της Αλβανίας κλέος, Ιλλυρικού η δόξα

⁴⁸ Ακολουθία του αγίου οσιομάρτυρος Νικοδήμου του μαρτυρήσαντος εν τη πόλει Βελαγράδων, κατά το αψθ' έτος, Ιουλίω ι'. Ποιηθείσα παρά του εν ιερομονάχους Γρηγορίου Μοσχοπολίτου. Duke u nisur nga të dhënat që na japin Zaviras-i dhe Peyfuss-i mund të themi se Grigor Moskopoliti dhe Grigori i Durrësit janë i njëjti person.

⁴⁹ Ακολουθία του αγίου ενδόξου βασιλέως, και μεγαλομάρτυρος Ιωάννου του Βλαδιμήρου και θαυματουργού / τυπωθείσα μεν πρώτον δαπάνη του τιμωτάτου Κυρίου Ιωάννου Παπά του εκ της πόλεως Νεοκάστρου' νυν δε ανατυπωθείσα κατά την έκδοσιν του Γλυκού του 1774 αναλώμασι των ευσεβών Κυρίων Ιωαννικίου Αρχιερέως, Γρηγορίου Ηγουμένου, Ιωάννου Τζούφκα, Κωνσταντίνου Συμεώνος, Αθανασίου Ιακώβου, Γεωργίου και υιού Ιωάννου Κρούνιτζ, των λεγομένων Κορώνα. Εν Βενετία. Εκ του Ελληνικπού Τυπογραφείου του αγίου Γεωργίου, 1858. Nuk mundëm të konsultojmë botimin e v. 1774, por mbështetemi te botimi i v. 1858.

[lavdimadhit të Shqipërisë, zulmëmadvhit të Ilirikut] Κατά του Άγαρ γένους, σπλίζου ημάς ρύσαι, του αεί τυραννούντος [ngjeshi armët për të na shpëtuar prej gjindjes së Agarëve, tiranëve të gjithkohshëm.]

Lexuesi le të vërejë se si këta “pishtarë”, të ndodhur në kërthizë të Shqipërisë së sotme, jo vetëm përpiqen të ngrenë një shqipe të përbashkët, por edhe kanë përfutur e përçojnë ndjenjën e të përkiturit në një truall të përbashkët.

Pa hyrë në komente më të hollësishme dhe duke pasur parasysh sa u thanë më sipër për historikun e përkthim-redaktimit të “Dhjatës së Re” të v. 1827, mund të pohojmë se kësajsoj përvijohen karakteristikat e njërit prej qarqeve kulturore e konfesionale, të atij ortodoks, dhe duket qartë se si krijohen kushtet për kalimin në fazën kombëtare të shqiptarëve.

Kur ndodhi ky kalim? Përgjigjen na e jep bindshëm, ndër të tjera, edhe shkrimi me titull “Arkeologji filologjike. Rreth gjuhës shqipe dhe kombit shqiptar”, i Athanas Armodhit, botuar në mars 1850 në gazetën “Athina” të Athinës (Qirjazi 2015). Duke folur për punë të alfabetëve shqip, autori vëren që N. Veqilharxhi “*ishte e mundur të merrte shkronjat latine me disa ndryshime, dhe të lehtësonte kështu edhe shtypjen edhe të mësuarit e të përhapurit e tyre*” dhe shton që “*Tashmë, disa njerëz, të nxitur nga zelli mëmëdhetar, u rrekën të botonin një alfabet të ri me shkronja latine, të cilin alfabet e përdorin edhe tani shumë shqiptarë, sikurse shkodranët...*”.

Mendoj se nga momenti që Korça ortodokse “zbulon” Shkodrën katolike, dhe kur te shqiptarët është nxitur dhe fuqizuar “zelli mëmëdhetar”, mund të themi plot gojë se ata kanë kaluar në fazën kombëtare të ekzistencës së tyre si bashkësi e dallueshme etnokulturore e gjuhësore.

Bibliografia

- Camarda, D. 1866. Appendice al saggio di Grammatologia Comparata sulla lingua albanese. Prato 1866.
- Camarda, D. 1867. Fylétia e Arbenoré préj kanekate laoshima, enkethyeme ne shkjipe perëi D. C. Livorno.
- Çabej, E. 1973. “Kuantiteti i zanoreve të theksuara të gjuhës shqipe”, në Studime rreth historisë së gjuhës shqipe, 117-127. Tiranë.
- Çabej, E. 1976-2014. Studime etimologjike në fushë të shqipes I-VII. Tiranë.
- Çabej, E. 1994. Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes. MÇM. Tiranë.
- Demiraj, B. 2019. Kodiku beratas – Ο μπερατινός κώδικας (me një botim kritik të pjesës shqip përgatitur nga Bardhyl Demiraj). Tiranë.
- Detrez, R. 2013. Pre-national identities in the Balkans, në R.Daskalov, Tch. Marinov (eds) Entagled Histories of the Balkans. Vol. I: National ideologies and Language Policies. Brill: Leiden – Boston, 13-65.
- D’ Istria, D. 1866. “La Nationalité albanaise d’après les chants populaires”, Revue des Deux Mondes T. 63.
- Elsie, R. 1995. The Elbasan Gospel Manuscript (Anonimi i Elbasanit), 1761, and the struggle for an original Albanian alphabet, Südost-Forschungen, Munich, 54, 1995, f. 105-159.
- Frashëri, N. 1896. Iliadhë e Omirit. Bucharest.
- Giakoumis, K. 2020. Kodiku Kishtar i Drinopojës dhe i Gjirokastrës (1760-1858) / Ο Εκκλησιαστικός Κώδικας Δρυϊνουπόλεως και Αργυροκάστρου (1760-1858). Tiranë.

- Giordano, E. 2000. Fjalor. Dizionario Arbëresh-Italiano / Vocabolario Italiano-Arbëresh. Castrovillari.
- Gurga, G. 2002-2005. Il Vangelo di San Mateo. Variante inedita del manoscritto di Piana. Edizione critica. Dottorato di Ricerca in Studi di Linguistica e Filologia Albanese 2002-2005. Università degli Studi della Calabria.
- Gurga, G. 2019. “Il manoscritto dell’Anonimo Epirota: alcune ipotesi filologiche”, në Matteo Mandalà e Gëzim Gurga (a cura di) *Aspetti e momenti dell’albanologia contemporanea*. Tiranë, 145-200.
- Haxhihasani, Q. 1971. “Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë”, *Dialektologjia Shqiptare I* 118-193.
- Kappler, M. 1993. *Turcismi nell’ “Alipasiadha” di Chatzi Sechretis*. Torino.
- Klosi, A. 2005. *Netët pellazgjike të Karl Reinholdit*. Tiranë.
- Koço, E. 2015. *Athanas Tashko (1863-1915)*. Tiranë.
- Kore, M. 2018. *Leksiku i Dhjatës së Re – burim i rëndësishëm për studimin e historisë së gjuhës shqipe*, në R. Memushaj (ed.) *Konferencë gjuhësore për nder të 80-vjetorit të lindjes së Prof.Dr. Xhevat Lloshit*. Tiranë, 183-194.
- Kristoforidhi, K. 1879. *Katër Ungjijtë edhe Punët e Apostojvet këthyerë prej greqishtes vjetërë shqip ndë gjuhë Toskërishte*. Constantinople.
- Kyriazis, D. 2012. “Kontakte gjuhësore në pashallëkun e Janinës, përmes dokumenteve të Arkivit të Ali Pashë Tepelenës”, në V. Maldjivej and K. Taczyńskiej (eds.) *Poznań Bałkany. Historia – Polityka – Kultura – Języki*. Toruń, 21-38.
- Kyriazis, D. 2015. «“Why Gypsies and Albanians do not have their own Letters”. *Greek Attitudes towards neighbouring Languages during the 19th Century*», *Slavia Meridionalis* 15, 228-240. Instytut Slawis tyki PAN.
- Lindstedt, J. 2016. “Multilingualism in the Central Balkans in late Ottoman times”, në M. Makartsev, M. Wahlström (ed.) *In Search of the Center and Periphery – Linguistic attitudes, minorities, and landscapes in the Central Balkans*, *Slavica Helsingiensia* 49, 51-67.
- Lloshi, Xh. 2012. *Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit*. Tiranë.
- Lloshi, Xh. et al. 2017. *Thesaret për gjuhën shqipe të Shoqërisë Biblike 18151833*. Tiranë.
- Lloshi, Xh. 2018. “The Translation of the New Testament into Albanian in a Balkan Perspective”, në D. Hosaflook (ed.) *Proceedings from the Balkan Conference on the 500th Anniversary of the Protestant Reformation*, Tiranë, 43-56.
- Mackridge, P. 2009. *Language and national identity in Greece, 1766-1976*. Oxford.
- Mandalà, M. (ed.) 2004. *Nicolò Chetta. Testi letterari in albanese*. Caltanissetta.
- Omari, A. 2000. “Veçori gjuhësore të përkthimit shqip të Dhjatës së Re të vitit 1827”, në *Vangjel Meksi (1770-1823) – personalitet i gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Omari, A. 2018. “Veçori gjuhësore të përkthimit të Ungjillit sipas Mateut nga Vangjel Meksi, 1820”, në R. Memushaj (ed.) *Konferencë gjuhësore për nder të 80-vjetorit të lindjes së Prof.Dr. Xhevat Lloshit*. Tiranë, 161-182.
- Pedersen, H. 1895. *Albanesische Texte mit Glossar*. Leipzig.
- Peypuss, M.D. (pa vit botimi). *Shtypshkronja e Voskopojës (1731-1769)*. Tiranë.
- Qendro, Th. 2016. *Dhjata e Re, përkthyer nga V.Meksi dhe redaktuar nga G. Gjirokastriti (1827), transkriptuar dhe pajisur me shënime nga dr. Thoma Qendro*. Tiranë.
- Qirjazi, Dh. 2014. “Përshkënditje të hershme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe iluminizmi grek”, në *Një Rilindje para Rilindjes, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare (Gjirokastër, May 2013)*, Universiteti “Eqrem Çabej”, 217-224.
- Qirjazi, Dh. 2015. “Nxitur prej zellit mëmëdhetar”. Tri dokumente për shqipen dhe shqiptarët,

të viteve 1850, në Studime në nderim të prof. Francesco Altimarit me rastin e 60-vjetorit të lindjes, Tiranë 2015, 555-571.

Qirjazi, Dh. 2018. “Thëngjijtë” e pashuar të Voskopojës: grishje për rilexim”, në F. Dado et al. (ed.) Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i Iluminizmit në Ballkan, Tiranë, 244-270.

Qirjazi, Dh. 2018a. «“Ngaha pema njihetë lisi”»: Përkthimi i V. Meksit i “Shenjtit Ungjill të Evangjelistit Markosë” dhe redaktimi i G. Gjirokastritit», në R. Memushaj (ed.) Konferencë gjuhësore për nder të 80-vjetorit të lindjes së Prof.Dr. Xhevat Lloshit. Tiranë, 195-220.

Sasse, H.J. 1991. Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland. Teil 1. Wiesbaden.

Skendi, S. 1964. “The emergence of the modern Balkan literary languages – a comparative approach”, në G. Reichenkron & A. Schmaus (Hrsg.) Die Kultur Südosteuropas, ihre Geschichte und ihre Ausdrucksforme. Wiesbaden.

Theotoky, B. 1826. Details sur Corfou. Korfuz.

Totoni, M. 1960. E folmja e Zagorisë, BUSHT, SSHSH.

Totoni, M. 1966. Vëzhgime rreth së folmes së qytetit së Gjirokastrës, Studime Filologjike, 1, 77-119.

Αναφορά 1820: *Αναφορά του Εφορείου της Γραφικής Εταιρείας των Ιωνικών (sic) Νήσων, προς την αυτήν Εταιρείαν και προς το κοινόν.* Εν Κερκύρα, τας 17 Σεπτεμβρίου.

Αναφορά 1825: *Τρίτη αναφορά του Εφορείου της Ιωνικής (sic) Γραφικής Εταιρείας προς την αυτήν Εταιρείαν και προς το κοινόν διά τους χρόνους 1823 και 1824.* Κέρκυρα.

Γιοχάλας, Τ. 1980. Τὸ ἑλληνο-ἄλβανικὸν λεξικὸν τοῦ Μάρκου Μπότσαρη (φιλολογικὴ ἔκδοσις ἐκ τοῦ αὐτογράφου). Athinë.

Γιοχάλας, Τ. 2002. Εύβοια. Τα αρβανίτικα. Athinë.

Γιοχάλας, Τ. 2006. Ὑδρα – λησμονημένη γλῶσσα, Α΄ + Β΄. Athinë.

Γιοχάλας, Τ. 2019. Τα αλβανόφωνα χωριά της Θράκης. Ιστορία και γλώσσα. Athinë.

Γρηγορίου.1827. Ἡ Καινὴ Διαθήκη τοῦ Κυρίου καὶ Σωτῆρος ἡμῶν Ἰησοῦ Χριστοῦ δίγλωττος, τοῦτέστι γραικικὴ καὶ ἄλβανητικὴ – Dhjata e Re e Zotit sonë që na shpëtoi Iisu Hrishtoit mbë di gjuhë, domethënë gërqishte edhe shqipëtarçe. Ἐπιστοασία Γρηγορίου Ἀρχιεπισκόπου τῆς Εύβοίας. Korfuz.

Παναγιωτόπουλος, Β. 2007, 2009. ΑΡΧΕΙΟ ΑΛΗ ΠΑΣΑ (Γενναδείου Βιβλιοθήκης). Ἐκδοση – Σχολιασμός – Εύρετήρια Β. Παναγιωτόπουλος με τὴ συνεργασία τῶν Δ. Δημητρόπουλου, Π. Μιχαηλάρη. Τ.: Α΄ (1747-1808), Β΄ (1809-1817), Γ΄ (1818-1821) Ἀθίνα 2007, Δ΄ Εἰσαγωγή – Εύρετήρια – Γλωσσάρι, Ε΄ 2018. Athinë.

Πυλαρινός, Θ. 2016. «Ο Γρηγόριος Αργυροκαστρίτης και η διπλή στοχοθεσία του», Ιονικά ανάλεκτα 6, 213-235.

Ρέππας, Χρ.Κ. 1989. «Ανέκδοτες επιστολές του Ηπειρώτη λογίου Μιχαήλ Βασιλείου σε προσωπικότητες του Ελληνισμού της διασποράς κατά την περίοδο 1821-1829», Ηπειρωτικόν Ημερολόγιον 1989 (11), Janinë, 271-363.

Σάθα, Κ.Ν.1870. Ἡ Ἀληπασιάς τοῦ τουρκαλβανοῦ Χατζῆ Σεχρέτη. Ἱστορικαὶ διατριβαί. Athinë.

Τζιβάρα, Π. 2003. «Οψεις της παιδείας στη Β. Ἠπειρο τον 18ο αἰώνα. Δύο βορειοηπειρωτικὰ χειρόγραφα», Ηπειρωτικὰ Χρονικά 37, 351-407.

ΤΟ ΚΑΤΑ ΜΑΤΘΑΙΟΝ
ΕΥΑΓΓΕΛΙΟΝ
ΤΟΥ ΚΥΡΙΟΥ ΚΑΙ ΣΩΤΗΡΟΣ ΗΜΩΝ
ΙΗΣΟΥ ΧΡΙΣΤΟΥ,
ΔΙΓΛΩΤΤΟΝ
ΑΠΑΘ-ΕΛΛΗΝΙΚΟΝ ΚΑΙ ΛΑΒΑΝΗΤΙΚΟΝ.

ΟΥΓΓΙΔΔΙ
ΙΗΣΟΥ ΧΡΙΣΤΟΪΤ
ΖΟΤΙΤ ΣΩΝΕ ΚΗ ΝΑ ΣΠΗΤΟΪ
ΣΙ ΚΟΙΝΤΡΕ ΣΣΚΡΟΥΑΝ ΣΣΕΝΤ ΜΑΤΘΑΙΟΥΑ
ΜΠΕ ΔΔΙ ΓΓΙΟΥΗΕ
ΓΚΕΡΚΙΣΤΕ ΕΑΕ ΣΣΚΙΠΕ.

ΚΟΡΦΟΙ,
ΕΝ ΤΗ ΤΥΠΟΓΡΑΦΙΑ ΤΗΣ ΔΙΟΚΗΣΕΩΣ.
1824.



Η ΚΑΙΝΗ
ΔΙΔΟΧΗ
Του Κυρίου και Σωτηρος ημων
ΙΗΣΟΥ ΧΡΙΣΤΟΥ
ΔΙΓΛΩΤΤΟΣ,
τουτέστι
ΓΡΑΙΚΙΚΗ και ΛΑΒΑΝΗΤΙΚΗ.

ΔΙΔΑΧΑ
Ε Ρ Ε
Ε Ζοτι σουε κε να ΣηετοΪ
ΙΗΣΟΥ ΧΡΙΣΤΟΪΤ
ΜΠΕ ΔΙΓΓΙΟΥΣΕ.
Σι με θεε
ΓΕΡΚΙΣΤΕ, ε δε ΣΚΙΠΕΤΑΡΤΖΕ.

ΕΠΙΣΤΑΣΙΑ
ΓΡΗΓΟΡΙΟΥ
Αρχιεπισκόπου της Εύβοιας.
ΚΟΡΦΟΙ
ΕΝ ΤΗ ΤΥΠΟΓΡΑΦΙΑ ΤΗΣ ΔΙΟΚΗΣΕΩΣ.
1827.

Raport i tretë i Komitetit të Shoqërisë Biblike Joniane, për vitet 1823 dhe 1824, drejtuar vetë Shoqërisë dhe publikut. Korfuz 1825 [f. 8-9]. (Përkthim i origjinalit greqisht, që jepet në vazhdim)

.....

Komiteti dha llogari me raportet e viteve 1820, 1821, dhe 1822, për pasojat fatmira të punës drejtuese të tij.

Mes numrit të ndërmarrjeve të tij, të cilat kanë përparësi pas kësaj periudhe, është, e para, botimi shqip i Ungjillit pas Mateut, dhe, e dyta, përhapja e Shkrimit të Shenjtë greqisht në Peloponez dhe në ishujt përbri.

Ky popull [shqiptari], një ndër më të vjetrit e Europës, para se të themelohej Shoqëria Biblike Joniane, nuk e pati marrë kurrë Ungjillin në asnjë gjuhë të kuptueshme për të. Janë pak vitet qyshkur u hodh ideja, me anë të Drejtuesve të saj, e cila përhapri në ato Vise [të Shqipërisë], për herë të parë, shpjegimin e Ligjit të Zotit. Dëshira e zjarrtë që u zgjua në ato vende (sapo mbërritën kopjet e shumëfishta të përkthimit të Shën Mateut) për të marrë edhe pjesën tjetër të Librit të Shenjtë, ka për t'i kurorëzuar përkujdesjet tona lidhur me këtë çështje.

.....

(1) Le të shtojmë se ky popull, kur njohu kryepari krishtërimin, e kuptonte gjuhën në të cilën qe shkruar Ungjilli, [por] nuk ka dyshim se prej disa shekujsh e deri më sot, ai nuk njihnte asnjë gjuhë përveçse shqipen, në të cilën nuk duket të ketë ndonjë përkthim me gërma greke nga ato që kemi sot.

(2) Një përkthim shqip i Dhjatës së Re i kryer prej të ndjerit Doktor Meksit, vendas prej Shqipërie, iu dërgua Shoqërisë nga i përnderuari zoti Leves, bashkëpunëtor i Shoqërisë së lartpërmendur në Kostandinopojë. Ai u bë shkak që Komiteti Jonian të ndërmarrë një përkthim të ri të përsosur të Dhjatës së Re, për të cilin po flasim, nga dora e Mitropolitit të Eubesë Grigorit, vendas edhe ky prej Shqipërie.

Tρίτη αναφορά του Εφορείου της Ιονικής (sic) Γραφικής Εταιρείας προς την αυτήν Εταιρείαν και προς το κοινόν διά τους χρόνους 1823 και 1824. Κέρκυρα 1825 [σ. 8-9].

.....

Το Εφορείον έδωκε λογαριασμόν με τας αναφοράς των 1820, 1821, και 1822, όλων των ευτυχών συνεπειών αίτινες προήλθον από την διοίκησίν του.

Μεταξύ του αριθμού των επιχειρήσεών του, αίτινες πρωτεύουσιν ύστερον από τιαούτην εποχήν, είναι πρώτον η έκδοσις η Αλβανική του Ευαγγελίου του Αγίου Ματθαίου, δεύτερον η διάχυσις των Ελληνικών Αγίων Γραφών εις την Πελοπόννησον, και εις τας προκειμένας νήσους.

Ούτος ο λαός εις από τους παλαιότερους της Ευρώπης, δεν έλαβε ποτέ το Ευαγγέλιον εις καμμίαν γλώσσαν νοητήν εις αυτόν, πριν της στερεώσεως της Ιονικής Γραφικής Εταιρείας. Ολίγοι χρόνοι είναι αφού η ιδέα εστάθη, με το μέσο των Διοικητών της, ήτις διέχυσε εις εκείνας τας Γειτονίας [της Αλβανίας], πρώτην φοράν, την εξήγησιν του Νόμου του Κυρίου εις την Απλοελληνικήν Γλώσσαν, αλλ' αυτή η πρόβλεψις δεν επλήρωνε τας χρείας των, επειδή δεν ήτον αυτή η γλώσσα η κοινοτέρα εις αυτάς.

Η Αλβανική Διάλεκτος ποτέ δεν εγράφετο τακτικώς, και εχρειάζετο να μεταχειρισθή ελληνικούς χαρακτήρας, διά να συνθέση εν ιδίωμα, διά του οποίου να εμπορή να καταστήση την μετάφρασιν νοητήν εις τον λαόν της Αλβανίας. Όλον τούτο επέτυχε διά των αγώνων της Εταιρείας, ήτις κατά τον σκοπόν της επρομηθεύθη από μίαν πρώτην έκδοσιν του Ευαγγελίου του Αγίου Ματθαίου, εις το οποίον ηθέλησε να προσθήση το Απλοελληνικόν κείμενον.

Η Αλβανία έντευθεν έγεινε μία νέα κατάκτησις του λόγου του Θεού, και οι εγκάτοικοί της, οι οποίοι έξων από τόσους αιώνας εις την αμάθειαν του νόμου των, αρχίζουν να αναγινώσκωσι, και να κάμνωσι να αναγινώσκειται το εις την γλώσσαν των καταστημένον βιβλίον το οποίον τον περιέχει (1).

Όσον από τας επιμελείας και διοικήσεις της Γραφικής Εταιρείας Βρεττανικής τε και ξένης, το Εφορείον ελπίζει να δημοσιεύση όλην την Νέαν Διαθήκην εις την Αλβανικήν Διάλεκτον, και καταγίνεται του νυν εις ένα Αλφάβητον προσφυέστερον εις ταύτην την χρήσιν (2).

Η ζωηρά επιθυμία ήτις ανηγέρθη εις ταύτας τας επαρχίας, (μόλις έφθασαν τα πολλαπλάσια αρχέτυπα της μεταφράσεως του Αγίου Ματθαίου,) διά να λάβωσι το υπόλοιπον του Θείου Βιβλίου, θέλει δικαιώσεν όλας τας περί ταύτην την υπόθεσιν φροντίδας μας.

.....
(1) Ακόμη προσθέτοντες ότι ούτος ο λαός κατ' αρχάς όταν εγνώρισε τον χριστιανισμόν ενόει την γλώσσαν εις την οποίαν το Ευαγγέλιον ήτον γραμμένον, είναι αναμφίβολον ότι από μερικούς αιώνας μέχρι τούδε, αυτός ηγνόει όλας τας γλώσσας ειμή μόνον την Αλβανικήν, εις την οποίαν δεν είναι φανερόν ότι υπάρχει καμμία μετάφρασις με Ελληνικούς χαρακτήρας παρά τους νυν γνωστούς.

(2) Μια μετάφρασις Αλβανική της Νέας Διαθήκης μεταφρασθείσης από τον ποτέ Δόκτορα Μεξικόν εγχώριον της Αλβανίας, ενεχειρίσθη εις την Εταιρείαν, την οποίαν έπεμψε ο αιδεσιμώτατος Κυρίος Η. Δ. Λήβης συνεργός της ρηθείσης Εταιρείας εν Κωσταντινουπόλει. Εκείνος είναι ο αίτιος ώστε το Ιονικόν Εφορείον να επιχειρισθή μίαν νέαν μετάφρασιν τελείαν της Νέας Διαθήκης, περί της οποίας είναι ο λόγος, διά του Αρχιεπισκόπου της Ευβοίας Γρηγορίου εγχωρίου και αυτού της Αλβανίας.